



VENDIM
Nr. 50, datë 31.1.2024

**PËR MIRATIMIN E PROFILIT TË
ZGJERUAR KOMBËTAR TË
MIGRACIONIT PËR VITET 2019–2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 138, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Profilit të Zgjeruar Kombëtar të Migracionit për vitet 2019–2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministritë e linjës për botimin e këtij profili në faqet e tyre zyrtare.

3. Ngarkohen të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera, të përmendura në dokumentin bashkëlidhur, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PROFILI I ZGJERUAR KOMBËTAR
I MIGRACIONIT
2019–2022**

Republika e Shqipërisë
Tiranë, 2024

Ky raport paraqet profilin e zgjeruar kombëtar të migracionit në **Republikën e Shqipërisë për periudhën 2019–2022**. Ai është hartuar mbështetur në pikën 5, të nenit 138, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”.

Informacioni i mbledhur dhe të dhënat e analizuar për përgatitjen e këtij profili janë siguruar kryesisht nga burime zyrtare. Profili i zgjeruar kombëtar i migracionit 2019–2022 gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Ministrave, si dhe të institucioneve përgjegjëse për hartimin e tij. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Profili i Zgjeruar Kombëtar i Migracionit është hartuar nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 63, datë 6.4.2020. Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të riprodhohet, kopjohet apo përcillet në asnjë

formë apo mënyrë, qoftë elektronike apo mekanike, përfshi fotokopjimin dhe regjistrimin, pa të drejtën e autorit (Ministria e Brendshme).

PASQYRA E PËRMBAJTJES

Lista e tabelave

Lista e figurave

Hyrje

Informacion i përgjithshëm

Përmbledhje

A. Situata dhe prirjet migratore

A.1 Migrimi i shtetasve shqiptarë

A.1.2. Lëvizjet migratore dhe karakteristikat e tyre

A.1.2.1 Emigracioni dhe format e tij; harta migratore

A.1.2.1.1 Azilkërkimi

A.1.2.2 Faktorët shtytës dhe tërheqës të emigrimit

A.1.2.3 Natyralizimi i shtetasve shqiptarë në vendet pritëse

A.1.2.3.1 Natyralizimi dhe lejet e qëndrimit në SHBA dhe në Mbretërinë e Bashkuar

A.1.2.4 Migracioni i kthimit dhe shërbimet e riintegrit

A.1.2.4.1 Flukset e kthimit

A.1.2.4.2 Shërbimet e riintegrit për migrantët e kthyer

A.1.2.5 Shërbime të tjera të mbrojtjes sociale

A.1.2.6 Prirja migratore

A.1.2.6.1 Projeksionet migratore sipas INSTAT-it

A.1.2.6.2 Hipotezat e emigrimit për burrat

A.1.2.6.3 Hipotezat e emigrimit për gratë

A.1.2.7 Migracioni i brendshëm

A.2 Imigrimi

A.2.1 Lëvizjet imigratore dhe karakteristikat e tyre

A.2.1.1 Imigrantët e rregullt me qëndrim në Shqipëri, 2019–2022

A.2.1.2 Studentët e huaj në institucionet shqiptare të arsimit të lartë

A.2.1.3 Flukset e përziera migratore

A.2.1.3.1 Trajtimi i azilkërkuesve, 2019–2022

A.2.1.3.2 Shqipëria si vend tranziti

B. Ndikimi i migracionit në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare

B.1 Migracioni dhe zhvillimi demografik

B.1.1 Popullsia e Shqipërisë



B.1.2 Migrimi i jashtëm në pakësimin e moderuar të popullsisë

B.1.3 Ndikimi i emigrimit në raportet e varësisë moshore dhe në strukturën e popullsisë

B.2 Migracioni dhe zhvillimi ekonomik

B.2.1. Dërgesat në para të emigrantëve si pjesë e investimeve të huaja direkte

B.2.2 Rritja ekonomike, mirëqenia dhe flukset migratore

B.2.3 Migracioni dhe tregu i punës

B.2.3.1 Ndikimi i tregut të punës në flukset migratore

B.2.3.2 Ndikimi i punësimit të të huajve në tregun e punës

B.3. Migracioni dhe shëndetësia

B.3.1 Ndikimi i emigracionit të specialistëve të shëndetësisë dhe sfidat e sistemit shëndetësor

B.3.2 Ndikimi i migrimit të brendshëm në konfigurimin e rrjetit të ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor

B.3.3 Rritja e rrezikut të sëmundshmërisë

B.3.4 Ndikimi i të kthyerve nga emigracioni në nevojën për mbulim me vaksina në Shqipëri

B.3.5 Nevoja për vaksinimin e personave që lëvizin në drejtim të vendeve me rrezikshmëri për sëmundje infektive

B.3.6 Rritja e rrezikut të infektimit me HIV/AIDS

C. Kuadri politik, ligjor dhe institucional për menaxhimin e migracionit, për periudhën 2019–2022

C.1 Kuadri politik për menaxhimin e migracionit

C.2 Kuadri ligjor për migracionin

C.2.1 Legjislacioni i brendshëm

C.2.2 Bashkëpunimi dypalësh

C.2.3 Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

C.3 Kuadri institucional

C.3.1 Institucionet qeveritare

C.3.2 Institucione të tjera publike

C.3.3 Aktorë të tjerë në fushën e migracionit

D. Përfundime dhe rekomandime

D.1 Përfundime

D.2 Rekomandime

D.2.1 Rekomandime për qeverisjen e migracionit

D.2.2 Rekomandime për zhvillimin e politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik kombëtar/lokal.

D.2.3 Rekomandime për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare

Ky raport analitik është produkt i një procesi të nisur në vitin 2007 nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), me hartimin e profilit të parë të migracionit në Shqipëri. Prej vitit 2021, hartimi i profileve vjetore të migracionit, si dhe i atyre të zgjeruara, bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, përmes një Grupi Ndërinstitucional Pune, që drejtohet nga Ministria e Brendshme.

Në këtë kontekst, Ministria e Brendshme shpreh mirënjohjen për të gjithë anëtarët dhe vëzhguesit e Grupit Ndërinstitucional të Punës, për pjesëmarrjen e tyre aktive dhe kontributin e vlefshëm në hartimin e Profilit të Zgjeruar Kombëtar të Migracionit, 2019–2022.

Lista e tabelave

Tabela A.1.2.1 Shtetasit shqiptarë me qëndrim të parregullt në BE

Tabela A.1.2.2 Të miturit e parregullt në BE

Tabela A.1.2.1.1 Shtetasit shqiptarë që kanë kërkuar azil

Tabela A.1.2.1.2 Të miturit azilkërkues

Tabela A.1.2.3.1 Shqiptarët që kanë fituar shtetësinë e shtetit pritës

Tabela A.1.2.4.1 Kthime vullnetare të asistuara nga IOM-ja, 2019–2022

Tabela A.1.2.4.2 Shtetasit shqiptarë të kthyer

Tabela A.1.2.4.3 Të mitur të kthyer nga vendet evropiane

Tabela A.1.2.4.4 Kthimi i të miturve shqiptarë nga vendet e BE-së me procedurë ripranimi

Tabela A.1.2.4.5 Kthimet e të miturve të pashoqëruar shqiptarë sipas shteteve

Tabela A.1.2.4.1 Të kthyerit e regjistruar në SM sipas shtetit të kthimit

Tabela 1.2.4.2.2 Të kthyerit e regjistruar në SM sipas shkakut të kthimit

Tabela 1.2.4.2.3 Të kthyerit të regjistruar në SM sipas grup-moshës

Tabela A.1.2.4.2.4 Të kthyerit sipas shërbimeve të përfituara në SM

Tabela A.1.2.5.1 Trajtimi i rasteve të fëmijëve të pashoqëruar

Tabela A.1.2.7.1 Koeficienti bruto i migracionit të brendshëm neto në nivel qarku



Tabela A.2.1.1 Shtetasit e huaj nga Afrika dhe Azia me qëndrim në Shqipëri

Tabela A.2.1.2.1 Të huajt me mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri

Tabela A.2.1.2.2 Vendime pezullimi të azilkërkimit sipas shtetësisë

Tabela A.2.1.2.3 Llojet e vendimeve të autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët

Tabela A.2.1.2.2.1 Të huajt të ndaluar

Tabela A.2.1.2.2.2 Të huajt e ndaluar në kufi ose në territorin shqiptar

Tabela A.2.1.2.2.3 Të huajt nga vendet e treta sipas shtetësisë

Tabela A.2.1.2.2.4 Të huajt e refuzuar në hyrje sipas llojit të PKK-së

Tabela A.2.1.2.2.5 Të huajt e refuzuar në hyrje sipas motivit

Tabela A.2.1.2.2.5 Statistikat për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit

Tabela B.1.1 Struktura e popullsisë sipas qarkut

Tabela B.1.2 Struktura e popullsisë sipas qarkut dhe gjinisë

Tabela B.2.3.1 Bilanci i forcave të punës

Tabela B.2.3.2 Numri i të papunëve sipas llojit të papunësisë

Tabela B.2.3.3 Nivelet e papunësisë sipas grup-moshave

Tabela B.2.3.2.1 Shpërndarja e lejeve të punës për të huajt

Tabela B.2.3.2.2 Miratimet e punësimit sipas shtetësisë

Tabela B.3.1 Pacientë të huaj që kanë marrë shërbim spitalor në vend

Tabela B.3.2 Shpërndarja e stafëve mjekësore në shërbimin parësor sipas zonave urbane dhe rurale

Tabela B.3.4.1 Mbulimi për çdo vaksinë të kalendarit kombëtar/vaksinimi

Tabela B.3.5.1 Mbulesa vaksinale kundër COVID-19

Tabela B.3.6.1 Prevalenca e HIV-AIDS/Rreziku i infektimit me HIV-AIDS

Tabela B.3.6.3 Vendi i marrjes së infeksionit HIV-AIDS (në%) për rastet e reja, bazuar në vendin e konfirmimit të diagnozës

Lista e figurave

Figura A.1.1 Dinamikat e migracionit

Figura A.1.2 Dinamikat e moshës mesatare

Figura A.1.3 Popullsia mesatare

Figura A.1.4 Treguesit demografikë

Figura A.1.2.1 Diaspora sipas grup-moshës, 2020

Figura A.1.2.2 Diaspora sipas gjinisë, 2020

Figura A.1.2.3 Shqiptarët e kapur në kufi të Mbretërisë së Bashkuar

Figura A.1.2.1.1 Dinamikat e azilkërkimit të të miturve përgjatë viteve

Figura A.1.2.1.2 Shqiptarët azilkërkues në SHBA

Figura A.1.2.2.1 Faktorët shtytës dhe tërheqës të emigrimit të shqiptarëve

Figura A.1.2.2.2 Lejet e qëndrimit të shqiptarëve në BE sipas arsyes

Figura A.1.2.3.1 Shqiptarët në SHBA

Figura A.1.2.3.2 Shqiptarët në Mbretërinë e Bashkuar

Figura A.1.2.4.1 Shtetasit shqiptarë të kthyer të regjistruar në SM, 2019–2022

Figura A.1.2.4.2 Shtetas shqiptarë të kthyer të paraqitur në SM sipas tipologjisë së kthimit

Figura A.1.2.4.2.3 Punëkërkuesit e papunë të cilët kanë filluar kurset e formimit profesional

Figura A.1.2.4.2.4 Nxënës të kthyer nga emigracioni në arsimin parauniversitar

Figura A.1.2.4.2.4.2.5 Fëmijë të kthyer të regjistruar në zyrat vendore të arsimit parauniversitar

Figura A.1.2.7.1 Tiparet demografike të migrantëve të brendshëm

Figura A.1.2.7.2 Lëvizjet e brendshme migratore sipas gjinisë

Figura A.2.1.1 Shtetas të huaj me qëndrim në Shqipëri sipas origjinës dhe gjinisë

Figura A.2.1.2 Shtetas të huaj me qëndrim në Shqipëri sipas origjinës

Figura A.2.1.3 Të huajt me qëndrim në Shqipëri sipas grup-moshës

Figura A.2.1.3 Lejet e qëndrimit sipas motivit

Figura A.2.1.4 Lejet e qëndrimit për të huajt sipas gjinisë

Figura A.2.1.5 Kërkesat për leje qëndrimit nga shtetasit e huaj, sipas qarkut

Figura A.2.1.6 Shtetas ukrainas të trajtuar me leje qëndrimi në RSH

Figura A.2.1.2.1 Studentët e huaj në institucionet shqiptare të arsimit të lartë

Figura A.2.1.2.1.2 Të huajt që studiojnë në Shqipëri

Figura A.2.1.2.2.1 Të huajt të ndaluar në QMH

Figura B.1.2.1 Treguesit demografikë të popullsisë

Figura B.1.2.2 Dinamikat e migracionit



Figura B.1.3.1 Popullsia sipas tri grup-moshave kryesore

Figura B.2.1.1 Dinamikat e dërgesave në euro nga emigrantë shqiptarë

Figura B.2.3.2.1 Leje unike të aprovuara

Figura B.2.3.2.2 Leje unike të aprovuara sipas aktiviteteve ekonomike

Lista e shkurtimeve

AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AFP	Arsimi dhe formimi profesional
BSH	Banka e Shqipërisë
DKM	Departamenti i Kufirit dhe Migracionit
DRAKPA	Drejtoria Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
EUROSTAT	Sistemi Evropian i Statistikave
FER	Regjistri Elektronik për të Huajt
FSHZHD	Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
GNP	Grupi Ndërinstitucional i Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
KVA	Kthim vullnetar i asistuar
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministri e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
PKK	Pikë e kalimit kufitar
QBD	Qendra e Botimeve për Diasporën
RSH	Republika e Shqipërisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SM	Sportel migracioni
SHVT	Shtetas të vendeve të treta
TIMS	Sistemi i Përgjithshëm i Menaxhimit të Informacionit
UNDESA	Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet Sociale dhe Ekonomike
VT	Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore
ZVAP	Zyrat vendore të arsimit parauniversitar



HYRJE

Profili i zgjeruar kombëtar i migracionit për vitet 2019–2022 ofron një panoramë të detajuar të tendencave dhe të dhënave të migracionit, përfshirë kuadrin politik, ligjor dhe institucional për menaxhimin e migracionit. Ky profil përfaqëson një komponent të rëndësishëm të angazhimit të Qeverisë Shqiptare për avancimin e Paktit Global për Migrim të Sigurt, të Rregullt dhe të Rregullt, veçanërisht në përmbushje të objektivit 1: Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave të sakta dhe të kategorizuara si bazë për politikën e orientuara nga faktet. Për më tepër, ai kontribuon në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE), dhe në kapitullin 18 të *acquis* të BE-së si dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Hartimi i raportit mbështetet në pikën 5, të nenit 138, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”.

Përgjegjës për përmbajtjen e këtij botimi është Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur me urdhrin nr. 63 të Kryeministrit, datë 6.4.2020. Informacioni i mbledhur dhe të dhënat e analizuar për përgatitjen e këtij profili janë siguruar kryesisht nga burime zyrtare.

Profili ofron të dhëna statistikore në nivel kombëtar të disegreguara rast pas rasti sipas gjinisë, periudhës kohore, moshës, duke ofruar një kontekst të vlefshëm për të bërë analiza krahasimore. Ky raport u hartua nga nevoja për të kuptuar më mirë dinamikën e migracionit me të cilën përballlet Shqipëria, si një vend origjine i tranzitit dhe së fundmi si vend destinacioni për të huajt.

Për sa i përket emigracionit, konteksti i lëvizjeve migratore shqiptare përmban të dyja tipologjitë e emigracionit, atij të rregullt dhe të parregullt. Shqipëria është dominuar rregullisht nga flukse të larta dalëse migratore. Shkalla e lartë e emigrimit të njerëzve të kualifikuar është një tjetër karakteristikë e migracionit shqiptar, sidomos në fushën e shëndetësisë. Për sa i përket azilkërkimit në BE, për periudhën 2019–2022, vihet re një ulje e kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë në vendet anëtare të BE-së dhe ato të *Schengen*-it, përkatësisht, nga 17 300 në vitin 2019, në 10 735 në vitin 2022. Shqetësues mbetet emigrimi i të miturve të pashoqëruar kryesisht drejt vendeve të BE-së.

Vlen të theksohet se ndër vite Shqipëria ka pësuar një rënie të ndjeshme të numrit të popullsisë, si rezultat i kombinimit të proceseve demografike të

uljes së lindshmërisë dhe emigracionit në shkallë më të madhe. Popullsia mesatare e Shqipërisë shkon në një trend rënës, nga 2019-ta më 2022-shin, popullsia mesatare ka rënë me 2.7%. Ndërkaq, ndonëse shtetasit e huaj përbëjnë një përqindje të vogël në raport me numrin e emigrantëve, ka një tendencë në rritje të imigrantëve të rregullt që qëndrojnë në Shqipëri për motive punësimi. Ndryshimet e fundit në kuadrin ligjor për të huaj mund të kenë lehtësuar në përshpejtimin e këtij numri.

Profili i migracionit eksploron çështjet kyçe dhe prioritetet e mundshme të ardhshme për qeverinë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: situatën dhe prirjet migratore të shtetasve shqiptarë, format, faktorët shtytës dhe tërheqës të emigracionit, migracioni i kthimit dhe shërbimet e riintegritimit karakteristikat e migrimit të brendshëm, situatën e migrantëve të rregullt dhe flukset e përziera migratore. Raporti përshkruan, gjithashtu, ndikimin e migracionit në tendencat demografike dhe zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe jep një panoramë të plotë të kuadrin politik për menaxhimin e migracionit, përfshirë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe kuadrin ligjor dhe institucional për migracionin.

Ky profil u mundëson ekspertëve, praktikuesve dhe politikëbërësve të kenë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të dhënave të përditësuara, tendencave dhe parashikimeve aktuale të migracionit.

Mbledhja e të dhënave është një proces sfidues, pasi kufizimet vijnë nga ndryshimet në dukurinë e migracionit, lëvizshmëria e lartë e njerëzve, mungesa e burimeve, përshtatja e përkufizimeve të ndryshme dhe/ose praktikave të mbledhjes së të dhënave, si dhe në tërësi nga mungesa e një sistemi të centralizuar për të mbledhur dhe analizuar të dhëna të sakta. Zhvillimi në të ardhmen i një instrumenti teknik dhe koherent krijon mundësi të mira për regjistrimin, mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave zyrtare të ofruara nga institucionet në Shqipëri.

Qëllimi është që ky raport të përditësohet rregullisht dhe, me çdo rishikim, të evidentojë dhe të përshpejtojë procesin e menaxhimit të migracionit në vend, si dhe mbledhjes së të dhënave të sakta bazuar në standardet dhe kërkesat e EU-së për mbledhjen e të dhënave në fushën e migracionit,

Raporti ofron edhe disa rekomandime për përmirësimin e statistikave migratore, si bazë për hartimin e politikave dhe ndërhyrjeve programore, shkurajimin e flukseve të parregullta migratore.



INFORMACION I PËRGJITHSHËM





Kryeqyteti: Tirana
 Sipërfaqja: 28 748 km² (tokë: 27 398 km², ujë: 1 350 km²)
 Kufiri: Gjatësia e përgjithshme: 1 079 km (tokësor: 717 km; detar: 362 km)
 Shtetet kufitare: Mali i Zi: 151 km; Kosova: 112 km; Maqedonia e Veriut: 172 km; Greqia: 282 km.

Popullsia: Popullsia sipas regjistrit të gjendjes civile: 4 503 781 banorë
 Popullsia sipas INSTAT-it (popullsia mesatare vjetore 2022): 2.761.785 banorë
 Dendësia: 99,7 banorë/km²

Gjuha: Gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe.
 Në territoret e banuara nga pakicat, përveç gjuhës shqipe, flitet dhe gjuha greke, serbokroate dhe maqedonase.


Presidenti: Bajram Begaj
 Kryeministri: Edi Rama
 Qeverisja: Republikë Parlamentare

A. SITUATA DHE PRIRJET MIGRATORE

A.1 Migrimi i shtetasve shqiptarë

Mosha mesatare e shqiptarëve, nga 2019-ta më 2022-shin është rritur nga 36,7 në 38, 2 vjeç (+4%), ndërkohë që përgjatë të gjitha viteve, mosha mesatare e popullsisë rritet me +0.5 vjeç (6 muaj). Nga viti 2019 më 2020-n mosha mesatare është rritur me 1.35% nga 36,7 në 37,2 vjeç.

Figura A.1.1 Dinamikat e migracionit




Burimi: INSTAT, 2023

Nga viti 2020 më 2021-shin mosha mesatare është rritur me 1% (nga 37,2 vjeç në 37,6 vjeç), ndërsa nga viti 2021 më 2022-shin mosha mesatare është rritur me 1.58% (nga 37,6 në 38,2 vjeç).




Figura A.1.2 Dinamikat e moshës mesatare



Burimi: INSTAT, 2023

Përgjatë viteve 2019–2022 vihet re një trend rënës i popullsisë nën 15 vjeç dhe i forcës së punës (15–64 vjeç) dhe një rritje e popullsisë mbi 65 vjeç. Përkatësisht, për vitin 2019 popullsia nën 15 vjeç përbënte 17.2% të popullsisë, për 2020 16.8%, për 2021 16.5% dhe për 2022 16.3%. Nga viti 2019 më 2022-shin ka një rënie prej 7.8% të popullsisë nën 15 vjeç. Popullsia, e cila është pjesë e forcës së punës në vitin 2019, përbënte 68.6%; më 2020: 68.4%, më 2021 përbënte 68.2%; dhe më 2022: 67.9%. Nga viti 2019 më 2022-shin numri i forcës së punës ka rënë me 3.4%. Ndërkohë që popullsia mbi 65 vjeç ka pësuar një trend rritës, nga 2019-ta më 2022-shin me 8.5%, përkatësisht, më 2019-n popullsia mbi 65 vjeç përbënte 14% të popullsisë, më 2020-n 14.7% të popullsisë, më 2021-shin 15.2% të popullsisë dhe më 2022-shin 15.7% të popullsisë së përgjithshme.


Figura A.1.3 Popullsia mesatare



Burimi: INSTAT, 2023

Popullsia mesatare e Shqipërisë ka pësuar një trend rënës, nga 2019-ta më 2022-shin, popullsia mesatare ka rënë me 2.7%. Ndërkohë që trendi i përgjithshëm është: numri i popullsisë gjatë viteve 2019–2022 ka rënë mesatarisht me 0.9% çdo vit.

Figura A.1.4 Treguesit demografikë



Burimi: INSTAT, 2023


Norma e rritjes së popullsisë dhe koeficienti bruto i shtesës natyrore për 2019–2022 kanë pësuar rënie. Përkatësisht nga 2019-ta më 2022-shin norma e rritjes së popullsisë ka rënë me -0.8, ndërkohë që gjatë viteve ka pasur një rend rënës me një mesatare prej -0.27. Nga 2020-ta më 2019-n norma e rritjes së popullsisë është ulur me -0.2; nga 2021-shi më 2020-n me -0.3; dhe nga 2022-shi më 2021-shin me -0.3. Sa i takon koeficientit bruto të shtesës natyrore, po ashtu shohim një rënie nga 2019-ta më 2022-shin me 2.1. Përkatësisht nga viti 2020 më 2019-n ka një diferencë me -2.1, nga 2021-shi më 2020-n një diferencë me -1.4, ndërsa për vitin 2021–2022 duhet se ka pasur trend rritës me një diferencë 1.4.

A.1.2. Lëvizjet migratore dhe karakteristikat e tyre

A.1.2.1 Emigracioni dhe format e tij; harta migratore

Konteksti i lëvizjeve migratore shqiptare përmban të dyja tipologjitë e emigracionit, atij të rregullt dhe të parregullt. Lëvizjet e rregullta migratore janë të vështira për t'u evidentuar nga statistikat e autoriteteve vendëse, për shkak të mungesës së një mekanizmi të regjistrimit për emigrantët përpara nisjes. Sidoqoftë, ekzistojnë statistika dhe të dhëna të tjera që ofrohen nga autoritetet e vendeve pritëse.

Figura A.1.2.1 Diaspora sipas grup-moshës, 2020




Burimi: INSTAT, 2023



Sipas të dhënave të INSTAT, më 2020-n, numri i përgjithshëm i diasporës shqiptare është 1 684 135. Pjesa më e madhe e të cilëve i përkasin grup-moshës 25–49 vjeç. Përkatësisht, grup-mosha me përqindjen më të madhe është ajo 35–39 vjeç, me 10.4%, ndjekur nga 30–34 vjeç, me 10.3%, 40–44 me 9.7% dhe më pas 25–29, me 8.5% dhe 45–49, me 8.3%.

Lidhur me ndarjen gjinore, 52.5% e diasporës shqiptare janë meshkuj (884 719) dhe 47.4% femra (799 416). Lidhur me grup-moshat sipas gjinisë, duket një trend i ngjashëm, pjesa më e madhe e femrave i përkasin grup-moshës 30–34 vjeç, ndërkohë që sa u takon meshkujve, pjesa më e madhe i takon moshës 35–39 vjeç me 10%. Pavarësisht se numri i përgjithshëm i meshkujve është më i lartë, duket se femrat kanë një shpërndarje më të njëtrajtshme të grup-moshës se sa meshkujt.

Figura A.1.2.2 Diaspora sipas gjinisë, 2020



Burimi: INSTAT, 2023

Vlen të theksohet se emigracioni bashkëkohor i shqiptarëve karakterizohet nga disa forma emigrimi, si ai për punësim të rregullt stinor ose afatgjatë, si për bashkim familjar, studime etj., por edhe nga emigracioni i parregullt. Ashtu si edhe vendet e tjera ballkanike, Shqipëria ka ende një nivel të lartë të emigracionit familjar, të grave dhe të fëmijëve, favorizuar nga afërsia kulturore, gjuhësore dhe gjeografike, nga kostoja e ulët e emigrimit në vendet fqinje, si Italia dhe Greqia, si edhe nga mundësitë ligjore për bashkim familjar në vendet kryesore pritëse. Shkalla e lartë e emigrimit të njerëzve të kualifikuar është një tjetër karakteristikë e migracionit shqiptar, sidomos në fushën e shëndetësisë.

Sakaq, emigrimi i parregullt nga Shqipëria drejt vendeve të tjera, kryesisht atyre të BE-së, vazhdon, çka e konfirmon edhe numri i individëve të ndaluar në kufi dhe territor, si dhe ai kthimeve të detyruara çdo vit. Sipas të dhënave të Eurostatit, nga viti 2019–2022 vërehet një rënie e konsiderueshme e qëndrimeve të parregullta me 7.52%, ndërkohë që në vitin në vijim (2021) konstatohet një rritje prej 10%.

Tabela A.1.2.1 Shtetasit shqiptarë me qëndrim të parregullt në BE

	2019	2020	2021	2022
Të parregullt				
Hyrje	33 285	30 870	34 150	-
<i>paligjshme/ mbiqëndrimi/ tjetër</i>				
Të refuzuar në kufi	21 260	13 315	18 565	-
Të urdhëruar për t'u larguar	30 905	23 150	21 990	23 860

Burimi: Eurostat, 2023

Numri i shqiptarëve të cilëve iu është refuzuar hyrja në një shtet të BE-së në kufi ka rënë ndjeshëm nga viti 2019 më 2021-shin, me një diferencë prej 13.4%. Po ashtu, numri i shqiptarëve të urdhëruar për t'u larguar nga territori i një vendi të BE-së ka pësuar një rënie prej 25.7%, gjatë katër viteve të fundit.




Tabela A.1.2.2 Të miturit e parregullt në BE

	2019	2020	2021	2022
Të parregullt	360	285	210	-

Burimi: Eurostat, 2023

Lidhur me numrin e të miturve, të cilët janë kapur duke qëndruar në mënyrë të parregullt në territorin e BE-së, ka rënë me 23.2% nga 2019-ta më 2020-n dhe me 52% nga 2019-ta më 2021-shin, duke mbajtur një trend përgjithësisht rënës. Përgjithësisht të miturit (nën 18 vjeç) e kapur duke qëndruar në mënyrë të parregullt në BE përgjatë 2019–2021 kanë qenë mesatarisht 0.8% e numrit të përgjithshëm.

Figura A.1.2.3 Shqiptarët e kapur në kufi të Mbretërisë së Bashkuar



Burimi: Home Office, 2023

Numri i dëbimeve të shqiptarëve të kapur në kufi me Mbretërinë e Bashkuar ka pësuar një rënie drastike nga 2019-ta më 2022-shin, nga 48% në vitin 2019 në 6.6% në vitin 2022. Gjithsej, gjatë periudhës kohore 2019–2022 janë dëbuar 3051 shqiptarë të kapur në kufi (15% e totalit).

Tabela A.1.2.3 Shtetasit shqiptarë të ndaluar përkohësisht në dalje nga territori

Viti	Numri i përgjithshëm i personave të ndaluar për të udhëtuar	Të ndaluarit për të udhëtuar në moshë madhore	Të miturit e ndaluar për të udhëtuar
Viti 2019	12224	868	13356
Viti 2020	6180	251	5929
Viti 2021	4611	343	4268
Viti 2022	6911	423	6488

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, 2023

Për vitin 2019, sa u takon ndalimeve në territor, pjesa më e madhe e të ndaluarve kanë qenë fëmijë. Për vitet 2019–2020 duket se numri i përgjithshëm i personave të ndaluar në kufi ka rënë ndjeshëm, 65.6% më pak. I njëjti trend ka vazhduar dhe për vitin në vijim, duke rënë me 29% për vitin 2021.

Ndërkohë që në vitin 2022 është parë një rritje e ndjeshme, krahasimisht me 2021-shin, prej 40%. Sa i takon harkut kohor 4-vjeçar, nga 2019 më 2022-shin numri i personave të ndaluar në kufi ka rënë me 55.5%.

Aktualisht, kanalet kryesore të emigracionit të parregullt përfshijnë: i. kufirin tokësor midis Shqipërisë, Greqisë dhe Malit të Zi, i cili vazhdon të funksionojë si korridor drejt zonës *Schengen* nëpërmjet Greqisë, Kroacisë dhe Sllovenisë për qytetarët shqiptarë, të cilëve u është ndaluar ligjrisht hyrja atje; ii. zgjatja e qëndrimit në vendet evropiane pas skadimit të afatit ligjor prej 90 ditësh; iii. aplikimi për azil pa pasur arsye të qenësishme dhe, kryesisht, për motive ekonomike; iv. braktisja e fëmijëve, lënia e tyre në vendet pritëse dhe kthimi i prindërve në Shqipëri, dukuri e cila ka rritur numrin e emigrantëve fëmijë të



pashoqëruar; v. shfrytëzimi i mundësisë për të hyrë lirisht në zonën *Schengen*, për ta përdorur më pas si trampolinë për të emigruar në mënyrë të parregullt në Mbretërinë e Bashkuar, SHBA dhe Kanada.

A.1.2.1.1 Azilkërkimi

Burimi kryesor i të dhënave për azilkërkimin në vendet e BE-së është baza e të dhënave e Eurostatit. Vendet kryesore ku shtetasit shqiptarë kanë kërkuar azil janë: Franca, Gjermania, Greqia, Suedia dhe Belgjika. Arsyet kryesore të kërkesës për azil janë kryesisht ekonomike, çka, për rrjedhojë, ka çuar në një numër të madh refuzimesh të kërkesave për azil nga vendet pritëse. Për periudhën 2019–2022 vihet re një ulje e kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë në vendet anëtare të BE-së dhe ato të *Schengen*-it, përkatësisht, nga 17 300 në vitin 2019, në 10 735 në vitin 2022.

Kërkesat për azil kanë pësuar ulje edhe në Francë, e cila është vendi kryesor pritës për azilkërkuesit shqiptarë, nga 8 510 në vitin 2019, në 5 690 në vitin 2022. Në Gjermani, numri i azilkërkuesve është ulur me 31%. Një tjetër vend i rëndësishëm destinacioni është Greqia, me 5 830 kërkesa për azil gjatë katër viteve të fundit.

Tabela A.1.2.1.1 Shtetasit shqiptarë që kanë kërkuar azil

Sipas vendndodhjes	Kërkesat për azil			
	2019	2020	2021	2022
Austria	50	15	35	35
Belgjika	540	270	440	445
Danimarka	55	15	10	25
Finlanda	25	0	10	15
Franca	8 510	2 010	4 885	5 690
Gjermania	1 695	815	1 210	1 745
Greqia	2 795	1 025	1 125	885
Kroacia	0	0	5	5
Islanda	45	10	10	15
Italia	1 545	450	760	1 280
Luksemburgu	55	20	10	25
Malta	0	0	0	5
Norvegjia	60	15	15	30
Portugalia	10	0	0	5
Slovenia	5	0	10	5
Spanja	120	50	60	40
Suedia	490	190	145	170
Zvicra	130	45	55	45
Gjithsej nga vendet e BE-së	17 065	4 990	8 840	10 645
Mbretëria e Bashkuar	3 453	2 784	4 522	14 223
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	727	391	368	358
Kanada	192	66	112	223
Australi	34	20	17	10

Burimi: Eurostat, Home Office, US Department of Homeland Security dhe UNHCR

Mbështetur në të dhënat e Eurostatit mbi azilkërkuesit për herë të parë në Evropë, rezulton se që prej vitit 2019 ka një prirje në rënie të shtetasve shqiptarë që kërkojnë azil, duke arritur në rreth 10 700 azilkërkues shqiptarë në vitin 2022. Në po këtë vit, vendi i cili ka tërhequr më shumë azilkërkues për herë të parë nga Shqipëria është Franca, me rreth 53% të azilkërkuesve gjithsej, ndjekur nga Gjermania me 16%, Italia 12%, Greqia me 8%.

Pavarësisht rënies së numrit të shqiptarëve që kanë kërkuar azil në vendet e BE, është parë një trend rritës i shqiptarëve që kërkojnë azil në Mbretërinë e Bashkuar, duke shënuar një numër prej 14 223 në vitin 2022.

Nga viti 2019, numri i shqiptarëve që kanë kërkuar azil në Mbretërinë e Bashkuar është rritur me 24.2%, ndërsa numri i azilkërkuesve në BE ka rënë me 62%.



Numri i aplikimeve për azil të aprovuara nga autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar është rritur përgjatë katërvjeçarit të fundit me 50.7%, ndërkohë që refuzimet kanë rënë nga 1291 në vitin 2019 në 424 në vitin 2022. Sa i takon mënyrës se si shqiptarët futen në Mbretërinë e Bashkuar, për katërvjeçarin e fundit mbizotëron kalimi nëpërmjet kufirit detar, pavarësisht se ka filluar të përhapet si fenomen gjatë vitin 2021.

Lidhur me azilkërkimin në SHBA Kanada dhe Australi, trendi ka qenë rënës për azilkërkuesit në SHBA, duke rënë me 49.2%, ndërkohë që në Kanada numri i azilkërkimeve është rritur nga 192 kërkesa më 2019-n, në 223 kërkesa më 2022-shin (86%). Sa i takon azilkërkimit në Australi numri ka qenë relativisht konstant, duke arritur maksimumin në vitin 2020, me 34 kërkesa.


Tabela A.1.2.1.2 Të miturit azilkërkues

	2019	2020	2021	2022
Belgjika	105	65	130	135
Bullgaria	0	0	5	0
Danimarka	20	5	0	5
Gjermania	580	300	510	785
Estonia	0	0	0	0
Irlanda	90	20	30	40
Greqia	540	145	220	220
Spanja	15	10	5	10
Franca	2,445	520	1,485	1,835
Italia	250	100	130	275
Luksemburgu	15	10	0	5
Holanda	50	25	5	5
Austria	10	0	10	10
Finlanda	10	0	5	5
Suedia	125	45	35	50
Islanda	5	0	5	10
Norvegjia	15	0	5	5
Zvicra	40	15	20	5
Mbretëria e Bashkuar	929	477	418	2,184
Bashkimi Evropian	4,260	1,240	2,565	3,380
Gjithsej	5,244	1,737	3,018	5,584

Burimi: Eurostat dhe Home Office, 2023

Shqetësues mbetet emigrimi i të miturve kryesisht drejt vendeve të BE-së. Pavarësisht një trendi rënës përgjatë 2020-s dhe 2021-shit, më 2022-shin, numri i të miturve që kanë kërkuar azil është rritur dhe ka kaluar numrin më 2019-n me 6.2%.

Figura A.1.2.1.1 Dinamikat e azilkërkimit të të miturve përgjatë viteve






Sa u takon shteteve me numrin me të lartë të azilkërkuesve të mitur, për 2019-n, pjesa më e madhe kanë kërkuar azil në Francë me 46.6%, ndjekur nga Mbretëria e Bashkuar me 17.7%, Gjermania me 11% dhe Italia me 10%. Më 2020-n, 29.9% kërkuan azil në Francë, 27.46% në Mbretërinë e Bashkuar dhe 17.2% në Gjermani. Në vitin 2021 gati gjysma e azilkërkuesve të mitur kanë aplikuar në Francë (49.20%), 16% në Gjermani dhe 14% në Mbretërinë e Bashkuar.

Për sa i përket vitit 2022, vihet re vazhdimi i një trendi rritës sa i takon azilkërkimit të të miturve në Mbretërinë e Bashkuar me 39.1%, ndjekur nga Franca me 32.8% dhe Gjermania me 14%.

Sa u takon vendimeve të marra për aplikimet, në SHBA, përgjatë 2019–2021 numri i refuzime ka qenë më i lartë se sa i aprovimeve, ndërkohë që më 2022-shin 67% e aplikimeve për azil janë aprovuar.

Figura A.1.2.1.2 Shqiptarët azilkërkues në SHBA




Burimi: United States Department of Homeland Security, 2023

A.1.2.2 Faktorët shtytës dhe tërheqës të emigrimit

Emigrimi i shtetasve shqiptarë motivohet nga faktorë shtytës po aq sa dhe tërheqës. Sipas INSTAT-it, 2023, faktorë kryesorë shtytës së emigrimit shqiptar mbeten mundësitë e punësimit, ndjekur nga bashkimi familjar, ndërkohë që shihet një rritje e mundësive të studimit përgjatë 2020–2022. Punësimi është një faktor sa shtytës aq edhe tërheqës, për sa kohë emigrimi perceptohet si një mundësi për punësim të kënaqshëm, që plotëson nevojat e individëve dhe familjeve të tyre.

Figura A.1.2.2.1 Faktorët shtytës dhe tërheqës të emigrimit të shqiptarëve




Burimi: INSTAT, 2023

Faktorët tërheqës përfshijnë mundësi më të mira punësimi dhe rritje profesionale jashtë vendit, mundësi edukimi, por edhe bashkimi familjar.

Sa u takon lejeve të qëndrimit të marra nga shqiptarët në BE, sipas të dhënave të Eurostatit, kryesojnë lejet e qëndrimit për arsye të bashkimit familjar, ndërkohë që vihet re një rritje e ndjeshme a lejeve të marra si të punësuar. Nga 155 411 leje qëndrimi të lëshuara nga shtetet e BE-së për shtetasit shqiptarë gjatë 2019–2021, 52.% prej tyre janë lëshuar për bashkim familjar, 24.7% për arsye të tjera, 19.4% për punësim dhe 3.4% për edukim.

Figura A.1.2.2.2 Lejet e qëndrimit të shqiptarëve në BE sipas arsyes



Burimi: Eurostat, 2023

A.1.2.3 Natyralizimi i shtetasve shqiptarë në vendet pritëse

Gjatë viteve të fundit, ritmet e legalizimit të emigrantëve shqiptarë në vendet evropiane kanë qenë të moderuara, për shkak se shumica e tyre rezultojnë të ligjruar gjatë dekadës së fundit. Sipas të dhënave të Eurostatit (që mbulojnë vetëm periudhën 2019–2021) për marrjen e shtetësisë së vendit pritës nga shtetasit shqiptarë për 27 vende evropiane në periudhën 2019–2021, Italia dhe Greqia vazhdojnë të mbeten shtetet kryesore evropiane për dhënien e shtetësisë shtetasve shqiptarë.

Tabela A.1.2.3.1 Shqiptarët që kanë fituar shtetësinë e shtetit pritës

	2019	2020	2021
Belgjika	353	317	365
Bullgaria	11	13	35
Çekia	6	2	5
Danimarka	1	5	7
Gjermania	485	385	480
Estonia	0	0	0
Irlanda	13	25	57
Greqia	14 050	10 795	7 736
Spanja	81	96	92
Franca	309	267	465
Kroacia	3	1	4
Italia	26 033	28 107	22 495
Qipro	5	6	4
Latvia	0	0	2
Lituania	0	0	00
Luksemburgu	33	16	27
Hungaria	5	4	7
Malta	5	8	8
Holanda	42	64	65
Austria	99	67	96




Polonia	7	10	11
Portugalia	3	5	3
Rumania	-	4	-
Slovenia	3	4	1
Slovakia	1	2	2
Finlanda	23	32	15
Suedia	132	264	384
Islanda	1	0	4
Lihtenshteini	0	0	0
Norvegjia	5	59	89
Zvicra	36	27	47
Gjithsej BE	41 703	40 499	32 364

Burimi: Eurostat, 2023

A.1.2.3.1 Natyralizimi dhe lejet e qëndrimit në SHBA dhe në Mbretërinë e Bashkuar

Sa i takon natyralizimit të shqiptarëve në SHBA, gjatë 2019–2021, numri i shqiptarëve që kanë fituar shtetësi amerikane është rritur me 535 ose me 16%, ndërkohë që numri i shqiptarëve që kanë marrë leje qëndrimi të përkohshme është ulur me 61.7% dhe lejet e përhershme të qëndrimit kanë rënë me 51.3%.


Figura A.1.2.3.1 Shqiptarët në SHBA



Burimi: US Department of Homeland Security, 2023

Sa i takon Mbretërisë së Bashkuar, lidhur me numrin e shqiptarëve që kanë fituar shtetësinë nga viti 2019 më 2022-shin, numri është rritur me 50%, po ashtu numri i shqiptarëve që kanë marrë leje qëndrimi përgjatë 2019–2021 është rritur me 33%.

Figura A.1.2.3.2 Shqiptarët në Mbretërinë e Bashkuar



Burimi: Home Office, 2023

A.1.2.4 Migracioni i kthimit dhe shërbimet e riintegritimit

A.1.2.4.1. Flukset e kthimit

Në kontekstin e migracionit shqiptar vërehen 2 tipologji kthimesh: i. kthimi vullnetar; ii. kthimi i detyruar. Kthimi vullnetar është ai që përfshin migrantët me status të rregullt në vendet pritëse, por edhe ata të cilëve u është mohuar kërkesa për azil, që zgjedhin të kthehen vullnetarisht në Shqipëri pas refuzimit përfundimtar të kësaj kërkesë. Në kthimin e detyruar përfshihen të gjithë migrantët shqiptarë me status të parregullt qëndrimi (përfshirë edhe azilkërkuesit e dështuar që nuk pranojnë të kthehen vullnetarisht në Shqipëri). Kthimi i detyruar ndodh kryesisht në kuadër të marrëveshjeve të ripranimit që Shqipëria ka nënshkruar. Vlen të theksohet se Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje ripranimi me BE-në, e cila është në fuqi që prej vitit 2006 për shtetasit shqiptarë¹. Kjo marrëveshje “Për ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim”, si dhe protokollet e zbatimit të saj, nënshkruar me vende anëtare të BE-së, janë zbatuar me korrektësi, paraqitur kjo dhe në raportin e fundit të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2022. Shqipëria nënshkroi dhe miratoi, gjithashtu, Marrëveshjen e Ripranimit me Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut. Për sa iu përket shtetasve e vendeve të treta që kapen në mënyrë të parregullt në vendin tonë, ata kthehen në vendin e tyre të origjinës përmes ripranimit dhe kthimit vullnetar. Janë në proces negociimi draftmarrëveshjet e ripranimit me shtetet e origjinës, si: Irak, Pakistan, India, Algjeria, Pakistani, Maroku, Greqi, si dhe 4 të tjera janë në procesin e draftimit, me shtetet, si: Bangladeshi, Emiratet e Bashkuara Arabe, Egjipti, Tunizia, Maroku, Iran, India, Algjeria etj.

Është e vështirë të përftohesh të dhëna administrative për kthimin vullnetar, duke qenë se janë më së shumti lëvizje që nuk kontrollohen nga institucionet qeveritare. Sipas të dhënave të IOM-it, kthimet vullnetare të asistuar nga kjo organizatë për periudhën 2019–2022 paraqiten, si më poshtë:

	2019	2020	2021	2022
Mbretëria e Bashkuar	303	0	0	0
Belgjikë	61	40	11	15
Zvicër	11	15	0	2
Norvegji	4	1	1	0

¹ Dispozitat për shtetasit e vendeve të treta hynë në fuqi në vitin 2008.



Islandë	3	238	0	0
Gjermani	838	0	19	19
Holandë	11	0	1	0
Irlandë	0	0	1	0
Gjithsej	1232	294	33	36
<i>Burimi: Databaza e IOM-së, 2023</i>				

Duket që ka një rënie të numrit të kthimeve të asistuar nga IOM-ja përgjatë katër viteve të fundit. Shtetet me numrin më të madh të kthimeve janë Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Islanda. Sipas Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, numri i të kthyerve nga 2019-ta më 2022-shin ka rënë me 47.3%. Duke shënuar numrin më të madh në 2019, vitet në vijim tregojnë për një trend përgjithësisht rënës, pavarësisht një rritje me 3% nga 2021-shi më 2022-shin, duke rënë me 49.4% nga 2019-ta më 2020-n, me 0.7% nga 2020-ta më 2021-shin.

Viti	2019	2020	2021	2022
Numri	12 404	7 485	7 427	7 652
<i>Burimi: DKM, 2023</i>				

Lidhur me të miturit shqiptarë të kthyer nga shtetet e Evropës, për vitet 2019–2022, pjesa më e madhe e kthimeve kanë ardhur nga Gjermania, Franca dhe Suedia. Vihet re se numri i kthimeve të të miturve është rritur ndjeshëm gjatë 2021-shit dhe 2022-shit dhe për 2020-n nuk ka pasur asnjë kthim. Për vitin 2019 ka pasur kthime vetëm nga Gjermania me 94 persona të mitur. Për 2021-shin dhe 2022-shin, përveç tri shteteve kryesore, kthime ka pasur dhe nga Austria dhe Norvegjia. Për 2021-shin: 70.2% e të miturve janë kthyer nga Gjermania; 12.7% nga Franca; dhe 0.6% nga Suedia. Për 2022-shin: 41.9% janë kthyer nga Gjermania; 23.4% nga Suedia; dhe 17.2% nga Franca.

	2019	2020	2021	2022
Belgjikë	0	0	0	15
Gjermani	95	0	165	170
France	0	0	30	70
Luksemburg	0	0	0	5
Hungari	0	0	0	5
Holandë	0	0	5	0
Austria	0	0	10	15
Finlandë	0	0	0	5
Suedi	0	0	25	95
Norvegji	0	0	0	15
Zvicër	0	0	0	10
Gjithsej	95	0	235	405
<i>Burimi: Eurostat, 2023</i>				

Sa u takon të miturve të cilët janë kthyer me procedurë ripranimi, ka një numër relativisht më të ulët se sa totali i kthimeve të fëmijëve. Kthimet me procedurë ripranimi janë ulur me 105.3% nga viti 2019 në vitin 2022, çka tregon për një rënie të ndjeshme, pavarësisht se krahasuar me 2021-shin, numri është rritur me dy të mitur.



Tabela A.1.2.4.4 Kthimi i të miturve shqiptarë nga vendet e BE-së me procedurë ripranimi

Viti	2019	2020	2021	2022
Kërkuar	171	76	51	53
Ripranuar	171	76	51	53

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, 2023

Lidhur me shtetet nga të cilët janë kthyer të miturit e pashoqëruar, për të gjithë katërvjeçarin: 46% janë kthyer nga Gjermania; 23% nga Franca dhe 7.5%; nga Britania e Madhe, Italia dhe Greqia respektivisht. Për vitin 2019: 39% u kthyen nga Gjermania; 23.9% nga Franca; dhe 11.1% nga Italia, ndërkohë që vetëm 9.3% u kthyen nga Britania e Madhe. Sa i takon vitit 2020, numri i përgjithshëm u ul me 76.9% dhe pjesa më e madhe e kthimeve ishin nga Gjermania. Në vitin 2021 numri i përgjithshëm u ul sërish me 39.3%, ku 19% e kthimeve ishin nga Gjermania, pjesa tjetër nga Franca, Britania e Madhe dhe Suedia. Në vitin 2022, numri i përgjithshëm u rrit me 3.8%, ndërkohë që shtetet kryesore mbeten Gjermania me 60.3% të të kthyerve dhe Franca me 37.7%.

Tabela A.1.2.4.5 Kthimet e të miturve të pashoqëruar shqiptarë sipas shteteve

	2019	2020	2021	2022
Greqia	5	7	2	0
Franca	41	7	13	20
Britania e Madhe	16	10	0	0
Zvicër	0	2	0	0
Suedia	13	10	3	1
Gjermania	68	33	29	32
Itali	19	3	4	0
Holanda	2	2	0	0
Norvegjia	2	0	0	0
Belgjika	5	0	0	0
Kosova	0	2	0	0
Totali	171	76	51	53


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, 2023

A.1.2.4.2. Shërbimet e riintegrit për migrantët e kthyer

Një pjesë e shtetasve shqiptarë që kthehen nga emigracioni paraqiten pranë sporteleve të migracionit (SM) që ndodhen në të gjitha zyrat rajonale dhe vendore të punësimit (40 gjithsej). SM-të janë struktura që ndihmojnë me shërbime tri kategori migrantësh, ata të mundshëm, të kthyerit dhe imigrantët. Nga këndvështrimi i shërbimeve për shtetasit shqiptarë të kthyer, SM-të lehtësojnë riintegrimin e tyre në vend pas kthimit (pavarësisht formës së kthimit, qoftë vullnetare ose jo), përmes orientimit drejt shërbimeve kryesisht publike, në përputhje me nevojat e tyre. Këto struktura intervistojnë të kthyerit që paraqiten në sportel, japin informacion për shërbimet publike dhe private në përputhje me nevojat e identifikuara, referojnë te shërbimet publike/private, si dhe në projekte specifike të shoqërisë civile, në përputhje me nevojat e tyre. Shtetasit e kthyer paraqiten vullnetarisht pranë sporteleve. Në tabelë paraqitet numri i shtetasve të kthyer të regjistruar në SM për periudhën 2019–2022.




Figura A.1.2.4.1 Shtetasit shqiptarë të kthyer të regjistruar në SM, 2019–2022



Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2023

Prej vitit 2019 vërehet një rënie e numrit të të kthyerve femra që janë paraqitur në SM, 94% dhe me 95% për të kthyerit meshkuj. Numri më i madh i kthimeve është afatgjatë dhe familjar. Kjo kategori e të kthyerve shfaq nevoja më të mëdha për mbështetje e shërbime riintegrimi. Ndërkohë, tipologjitë e shtetasve të kthyer që janë paraqitur në SM kanë mbetur të njëjta në katër vitet e fundit.

Figura A.1.2.4.2 Shtetas shqiptarë të kthyer të paraqitur në SM sipas tipologjisë së kthimit



Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2023

Dy vendet kryesore nga janë kthyer shtetasit shqiptarë janë Greqia dhe Italia. Sidoqoftë, pas vitit 2020 vërehet një ulje e prirjes së kthimeve nga këto dy vende, në raport me kthimet nga vendet e tjera të BE-së.



Tabela A.1.2.4.1 Të kthyerit e regjistruar në SM sipas shtetit të kthimit

Shteti/viti:	2019		2020		2021		2022	
Greqi	179	32%	49	21%	50	21%	2	6%
Itali	122	22%	41	17%	48	21%	10	31%
Vende të tjera të BE-së	232	42%	140	59%	130	56%	11	34%
Vende joanëtare të BE-së	22	4%	7	3%	5	2%	9	28%

Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2023

Shumica e kthimeve, sipas deklarimeve të të kthyerve, ka ndodhur për shkak të mungesës së dokumentacionit, ndjekur nga kthimet për shkak të papunësisë në këto vende. Në vitin 2019, vërehet se këto dy motive janë pak a shumë në nivele të njëjta. Gjatë vitit 2022, asnjë prej të kthyerve nuk ka deklaruar se shkak i kthimit është investimi në Shqipëri e, megjithatë, kjo mund të shpjegohet me faktin se kjo kategori të kthyerve vjen me një plan të mirëmbuar investimi dhe punon për ta vënë në zbatim, duke u paraqitur vetëm në ato institucione me të cilat lidhet ngushtësisht investimi.

Tabela 1.2.4.2.2 Të kthyerit e regjistruar në SM sipas shkakut të kthimit

Shkaku i kthimit/viti	2019		2020		2021		2022	
Papunësia	222	40%	56	24%	73	31%	17	53%
Mungesa e dokumentacionit	234	42%	137	58%	123	53%	11	34%
Për investime	12	2%	9	4%	11	5%	0	0%
Shkaqe të tjera	87	16%	35	15%	26	11%	4	13%

Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2023

Pjesa më e madhe e shtetasve të kthyer shqiptarë, të paraqitur në SM, janë mbi 25 vjeç. Nuk ka ndryshim të madh sa i përket shpërndarjes së të njëjtës grup-moshë në vite.

Tabela 1.2.4.2.3 Të kthyerit të regjistruar në SM sipas grup-moshës

Grup-mosha/viti	2019		2020		2021		2022	
15 deri 24 vjeç	105	19%	27	11%	22	9%	2	6%
25 deri 34 vjeç	132	24%	87	37%	92	39%	10	31%
35 deri 44 vjeç	151	27%	71	30%	68	29%	11	34%
45 e në vazhdim	167	30%	52	22%	51	22%	9	28%

Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2023

Shumica dërrmuese e të kthyerve të paraqitur pranë SM-ve në periudhën 2019–2022 kanë nxjerrë si nevojë parësore gjetjen e një pune, për të cilën kanë marrë ndihmë (me regjistrim, këshillim formim profesional etj.). Ky grup ndiqet nga grupi i të kthyerve që kanë kërkuar të marrin informacion rreth formimit profesional, sidomos gjatë vitit 2020. Një pjesë e të kthyerve kanë marrë informacion për shërbimet mjekësore. Në tabelë paraqitet numri i të kthyerve të regjistruar gjatë katër viteve të fundit, sipas shërbimeve të përfituara. Numri i emigrantëve të kthyer të regjistruar si punëkërkues të papunë në Zyrat Vendore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që kanë marrë pjesë në kurset e formimit profesional për periudhën janar 2023–korrik 2023 mbetet shumë i vogël. Vetëm 8 emigrantë të kthyer punëkërkues kanë marrë pjesë në këto kurse, në zyrat vendore të AKPA, Tiranë dhe Shkodër.

Në muajin korrik 2023, stoku i emigrantëve të kthyer të regjistruar si të papunë në strukturat e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive është 423 individë. Rritja e tyre që prej muajit janar 2023, ku rezultoi 377 emigrantë të kthyer të regjistruar, mund të konsiderohet e përmbajtur. Krahasuar me stokun e të papunëve të regjistruar në total që rezultojnë në korrik 2023, 77.793, numri i tyre është i vogël. Në muajin korrik 2023 janë punësuar gjithsej 40 emigrantë të kthyer të regjistruar në zyrat e punësimit, por vetëm 16 prej tyre janë punësuar nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.




Tabela A.1.2.4.2.4 Të kthyerit sipas shërbimeve të përfituara në SM

Shërbime të përfituara	2019		2020		2021		2022	
Këshillim për punësim	290	52%	49	21%	87	37%	28	88%
Orientim profesional	211	38%	98	41%	65	28%	4	13%
Informim për shërbimet mjekësore	19	3%	11	5%	11	5%	0	0%
Mbështetje me të ardhura	17	3%	16	7%	1	0%	4	13%
Hapje biznesi	13	2%	5	2%	4	2%	0	0%
Shërbime të tjera	66	12%	99	42%	85	36%	0	0%

Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2023

Gjatë periudhës 2019–2022 kanë marrë pjesë në kurset e formimit profesional pranë qendrave publike të formimit profesional 177 të kthyer.

Figura A.1.2.4.2.3 Punëkërkuarit e papunë të cilët kanë filluar kurset e formimit profesional




Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2023

Numri i përgjithshëm i të kthyerve, të cilët kanë filluar kurset e formimit profesional ka pësuar një trend rënës nga 2019–2022, duke rënë me 89% nga 73 në 8.

Të kthyerit në moshë shkollare trajtohen me përparësi dhe u krijohen lehtësi për përfshirjen në sistemin arsimor. Në çdo fazë të vitit shkollor, zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) bëjnë njësimin e dokumenteve shkollare që ata sjellin me vete dhe i regjistrojnë në shkollë. Kur është e nevojshme, ata mbështeten edhe me program individual për gjuhën shqipe dhe për lëndë të veçanta.


Figura A.1.2.4.2.4 Nxënës të kthyer nga emigracioni në arsimin parauniversitar



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, 2023

Duke iu referuar të dhënave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në vitin shkollor 2019–2020, në arsimin parauniversitar janë regjistruar mbi 1 013 fëmijë të kthyer nga emigracioni, për vitet 2020–2021 janë regjistruar 24% më pak (796 nxënës); për vitin 2021–2022 janë regjistruar 16.8% më pak (672 nxënës) dhe për 2022–2023 janë regjistruar 1.6% më pak se në vitin akademik 2021–2022, dhe 42% më pak se sa në vitin akademik 2019–2020.

Figura A.1.2.4.2.4.2.5 Fëmijë të kthyer të regjistruar në zyrat vendore të arsimit parauniversitar



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, 2023

A.1.2.5 Shërbime të tjera të mbrojtjes sociale

Në kuadër të reformave në fushën e mbrojtjes sociale, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative socio-ekonomike, ndër to dhe fenomeni i migrimit, një nga reformat sociale të rëndësishme është mbështetja financiare e individëve dhe familjeve në nevojë, për një periudhë deri në dy vjet, pasi qëllimi final është integrimi i tyre në jetën social-ekonomike, duke shtrirë skemën e reformuar e ndihmës ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë. Në kuadër të kësaj reforme u miratua dhe programi i ri i nxitjes së punësimit me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 162/2018, “Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional”, i cili synon, që në kuadër të orientimit të qeverisë për aktivizimin e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe personave, që dalin nga kjo skemë, përfshirjen e tyre në programet e formimit profesional, duke i mbështetur me dhënie e pagesës në nivelin prej 50% të pagesës së papunësisë, në mënyrë që të marrin një profesion dhe të riaktivizohen në tregun e punës.

Prioritet tjetër kryesor i programeve të mbrojtjes sociale është zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, për të siguruar mospërrjashtimin social,

nëpërmjet lehtësimit të aksesit të shërbimeve sociale komunitare, qeveria shqiptare miratoi për herë të parë ligjin për shërbimet sociale nr. 121/2016 parashikojnë masa specifike mbrojtëse për personat në nevojë për mbrojtje/kategoritë vulnerabël, por për të siguruar parandalimin dhe kontrollin e migracionit të parregullt, duke mbrojtur të drejtat e migrantëve, ky ligj ka nevojë për përmirësime të mëtejshme ligjore.

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shportë minimale të shërbimeve shoqërore të ofruara në komunitet, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 518/2018, ku për herë të parë parashikohen tipologji të reja shërbimi, kryesisht me bazë komunitare, multifunksionale, si dhe shërbimet e ndërhyrjes së hershme, informimit, mbështetjes psikosociale, ku kategori përfituese janë dhe të kthyerit nga migracioni.

Në kontekstin e ligjit të ri, decentralizimit fiskal dhe administrativ në Shqipëri, shërbimet e domosdoshme publike po delegohen te qeveritë lokale (shërbimet e kujdesit social) dhe kërkojnë mekanizma të rinj financimi dhe menaxhim efektiv për ofrimin e shërbimeve të koordinuara ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Koncepti i fondit



social kombëtar për mbështetjen e shërbimeve të kujdesit social në nivel lokal u konkretizua në vitin 2018 (VKM nr. 111/2018). Një program tjetër social, për sigurimin e riintegritimit social të të kthyerve nga migracioni, është krijuar i ndërmarrjeve sociale. Miratimi i ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, ka përcaktuar më së miri qëllimin e krijimit dhe të funksionimit të tyre; të rregullojë integrimin dhe riintegrimin e personave të përjashtuar nga tregu i punës, ku një nga kategoritë e grupeve të personave të pafavorizuar janë punonjësit migrantë që zhvendosen ose janë zhvendosur brenda vendit (VKM nr. 56/2018).

Me miratimin e ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, do të përfitojnë strehim 24 kategori, të cilat nuk i kanë mundësitë e sigurimit të një banese të re. Përfitojnë nga programet e strehimit social të këtij ligji shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”, si dhe emigrantët e rikthyer.

Në zbatim të politikave shtetërore për ndërtimin e një shoqërie të mundësive të barabarta dhe pa dhunë, shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofrojnë këto ligje,

në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. Po ashtu edhe personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofrojnë këto ligje, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. Gratë migrante përfitojnë shërbimet që ofrohen për dhunën në familje në Republikën e Shqipërisë si të gjitha gratë e vajzat e tjera, shërbime të tilla strehimi, këshillimi ligjor dhe psikosocial. Këto politika janë mbështetur dhe me ndryshimet ligjore, korrik 2018, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Me miratimin e ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, parashikohen masa specifike mbrojtëse për fëmijët, ku përfshihen dhe të miturit e pashoqëruar, që përkufizon fëmijën e ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor. Çdo politikë, program apo dhe kuadër ligjor i hartuar për fëmijët, udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, ku është përcaktuar, gjithashtu, edhe e drejta e fëmijës për t’u dëgjuar, me qëllim krijimin e një mjedis jo vetëm ku fëmijët të rriten të sigurt e të mbrojtur, por edhe të kenë mundësi të zhvillojnë potencialin e tyre.

Tabela A.1.2.5.1 Trajtimi i rasteve të fëmijëve të pashoqëruar

	2019	2020	2021	2022
Kërkesat për vlerësim social	111	64	42	54
Vlerësimit sociale të kryera	111	64	42	54
Riatdhesimet	34	9	9	22

Burimi: Agjencia e Fëmijëve dhe Shërbimit Social Shtetëror/MSHMS/MEPJ

Gjatë vitit 2019, duke koordinuar punën me strukturat e Agjencisë së Fëmijëve dhe Shërbimit Social Shtetëror mbi vlerësimin e familjeve të të miturve të pashoqëruar, janë trajtuar 111 kërkesa për vlerësime dhe nga këto janë realizuar 111 vlerësime sociale dhe është koordinuar puna për pritjen e 34 riatdhesimeve. Për vitin 2020 ka pasur 64 kërkesa, të cilat kanë ardhur nga MPJ-ja dhe MSHMS-ja, për vlerësim social-ekonomik të familjeve të të miturve që janë kapur nga autoritetet e huaja, nga këto janë realizuar 64 vlerësime sociale dhe është koordinuar puna për pritjen e 9 riatdhesimeve. Për vitin 2021 ka pasur 42 kërkesa për vlerësim social-ekonomik të familjeve të të miturve që janë kapur nga autoritetet e huaja, nga këto janë realizuar 42 vlerësime sociale

dhe është koordinuar puna për pritjen e 9 riatdhesimeve. Gjatë vitit 2022 janë trajtuar 54 kërkesa për vlerësime dhe nga këto janë realizuar 54 vlerësime sociale dhe është koordinuar puna për pritjen e 22 riatdhesimeve.

Vizioni i ri i qeverisë shqiptare në lidhje me komunitetin rom dhe egjiptian, si një nga kategoritë kryesore të flukseve migratore parashikuar në Planin Kombëtar të Veprimit për Romët dhe Egjiptianët, VKM-në nr. 1072/2015 është rritja e aksesit në shërbimet publike nëpërmjet heqjes së vazhdueshme të barrierave, gjë e cila do të sjellë një shëndet më të mirë, një arsimim më të plotë, rritje të mirëqenies nëpërmjet punësimit formal e si pasojë integrimin të plotë të këtyre komuniteteve.



A.1.2.6 Prirja migratore

A.1.2.6.1 Projektionet migratore sipas INSTAT-it²

Sipas INSTAT-it, popullsia e Shqipërisë në vitin 2031, sipas projeksioneve të përditësuara, llogaritet se do të jetë 2 922 749 banorë. Ky numër është rreth 176 753 banorë më shumë krahasuar me numrin e popullsisë në projeksionet e popullsisë 2015–2031. Një ndryshim i tillë është pasojë e drejtpërdrejtë e normave të lindshmërisë dhe shpërndarjes gjinore të emigrantëve. Gjatë periudhës 2011–2022, normat e emigrimit të burrave rezultuan më të larta se ato që u supozuan në projeksionet e mëparshme. Ndërsa për gratë, situata ishte e kundërta, me norma emigrimi disa herë më të ulëta se ato të supozuara më parë. Këto ndryshime në sjelljet migratore kanë çuar edhe ndryshimin e strukturës gjinore të popullsisë.

Për ndërtimin e hipotezave të emigrimit, INSTAT-i përdor indeksin sintetik i migrimit, i cili paraqet shumën e normave specifike të emigrimit dhe llogaritet sipas gjinisë. Gjatë periudhës 2011–2018, ky indeks, ndryshe nga parashikimet, vazhdoi të rritej për burrat, nga 1,45 më 2011-n, deri në 1,6 më 2018-n, ndërsa për vitin 2026 parashikohet të jetë 1.54 dhe për 2031-shin, 1.5. Në të njëjtën kohë, për po këtë periudhë, indeksi sintetik i migrimit për gratë pësoi një rritje domethënëse, nga 0,35 më 2018 deri në 0,61 më 2026-n. Këto ndryshime në sjelljet migratore të burrave dhe të grave, edhe pse prodhojnë një numër të përgjithshëm emigrantësh, në përputhje me atë që tregojnë projeksionet e popullsisë 2019–2031, kanë tjetërsuar në mënyrë të konsiderueshme përbërjen e tyre gjinore.

A.1.2.6.2 Hipotezat e emigrimit për burrat

Për ndërtimin e hipotezave të emigrimit për burrat, u vendos që në variantin e mesëm të tyre

indeksi sintetik i migrimit të arrinte në nivelet e parashikuara nga hipoteza e emigrimit të lartë në projeksionet e popullsisë 2019–2031. Kjo do të thotë që në variantin e mesëm, ISM-ja për burrat do të arrijë sipas një funksioni linear nga 1,6 në vitin 2018, në 1,1 në vitin 2031. Me anë të të njëjtit funksion, vlera e ISM-së në variantin e ulët mendohet të arrijë 0,7 në vitin 2031, ndërsa në variantin e lartë supozohet të arrijë vlerën 1,5.

A.1.2.6.3. Hipotezat e emigrimit për gratë


Për ndërtimin e hipotezave të emigrimit për gratë, u vendos që në variantin e mesëm të tyre, indeksi sintetik i migrimit të arrinte në nivelet e parashikuara nga hipoteza e emigrimit të ulët në projeksionet e popullsisë 2011–2031. Kjo do të thotë që, në variantin e mesëm, ISM-ja për gratë do të arrijë sipas një funksioni linear nga 0,35 në vitin 2018, në 0,5 në vitin 2031. Me anë të të njëjtit lloj funksioni, vlera e ISM-së në variantin e ulët mendohet të arrijë 0,35 në vitin 2031, ndërsa në variantin e lartë supozohet të arrijë vlerën 0,8.

A.1.2.7 Migracioni i brendshëm

Ndryshimet e popullsisë së qarqeve, rritja ose rënia e popullsisë së tyre, ndikohen jo vetëm nga dy komponentët kryesorë të ndryshimit të popullsisë (shtesa natyrore dhe migracioni neto), por edhe nga lëvizjet e brendshme. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme, gjatë vitit 2019, rreth 64 mijë banorë u zhvendosën brenda vendit, duke ndryshuar qarkun, qytetin ose fshatin e vendbanimit të zakonshëm. Në vitin 2019, ky numër ishte rreth 17 mijë banorë, në vitin 2020 rreth 14 mijë banorë, në vitin 2021 rreth 17 mijë banorë dhe në vitin 2022, 15 mijë banorë.

² Për më shumë informacion, shihni në adresën e mëposhtme:

Figura A.1.2.7.1 Tiparet demografike të migrantëve të brendshëm




Burimi: INSTAT, 2023

Vërehet se migrantët e brendshëm janë përgjithësisht të rinj. Më shumë se 50% e migrantëve të brendshëm i përkasin grup-moshës 20–34 vjeç, ndërkohë grup-mosha 30–34 vjeç përbën rreth 20% të migrantëve të brendshëm. Tiparet demografike të migrantëve të brendshëm paraqiten në figurën e mëposhtme.

Lidhur me tiparet gjinore të migracionit të brendshëm vihet re se femrat kanë një tendencë më të lartë për të migruar: për vitin 2022 ato zënë 60.5% të numrit të përgjithshëm të migrantëve të brendshëm, duke pësuar një rritje me 1.97% nga viti 2021. Ndërkohë që numri i përgjithshëm i migrantëve të brendshëm ka rënë me 14% nga viti 2019 dhe me 18.5% nga viti 2021, ndërkohë që nga viti 2020 në 2021 ka pësuar një rritje me 18.4%.

Figura A.1.2.7.2 Lëvizjet e brendshme migratore sipas gjinisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, 2023

Koeficienti bruto i migracionit të brendshëm neto tregon ndikimin që ka migracioni i brendshëm në popullsinë e qarqeve specifike. Gjatë 2019–2022, vetëm Tirana ka një migrim të brendshëm pozitiv. Të gjitha prefekturat e tjera kanë pasur migracion të brendshëm neto negativ gjatë viteve 2019–2022 dhe, në veçanti, qarqet e Dibrës, të Gjirokastrës dhe të Kukësit.

Tabela A.1.2.7.1 Koeficienti bruto i migracionit të brendshëm neto në nivel qarku

	2019	2020	2021	2022
Berat	-10,9	-8,4	-13,2	-9,7
Dibër	-20,7	-16,1	-25,8	-16,9
Durrës	5,9	8,4	7,6	4,1
Elbasan	-6,4	-4,8	-7,0	-5,0
Fier	-4,8	-2,8	-5,2	-4,3
Gjirokastrë	-17,7	-9,1	-21,4	-12,1
Korçë	-5,3	-3,7	-7,1	-5,4
Kukës	-13,5	-11,7	-15,7	-10,4



Lezhë	-4,5	-4,8	-5,5	-3,7
Shkodër	-2,7	-4,1	-3,4	-2,7
Tiranë	10,5	6,7	11,7	8,0
Berat	-10,9	-8,4	-13,2	-9,7

Burimi: INSTAT, 2023

A.2 IMIGRIMI

A.2.1 Lëvizjet imigratore dhe karakteristikat e tyre


Kur bëhet fjalë për imigracionin, Shqipëria është vend destinacioni për migrantët e rregullt që dëshirojnë të jetojnë në Shqipëri për arsye të ndryshme, për ata që kërkojnë azil, si dhe vend tranziti dhe destinacioni për migrantë të parregullt dhe azilkërkues, që synojnë kryesisht vendet e BE-së.

A.2.1.1 Imigrantët e rregullt me qëndrim në Shqipëri, 2019–2022

Mbështetur në të dhënat e Regjistrimit Elektronik për të Huajt, përgjatë viteve 2019–2022 numërohen 20 268 shtetas të huaj me qëndrim në Shqipëri, të cilët u përkasin kategorive në vijim: imigrantë të rregullt ekonomikë, studentë, azilkërkues; të huaj të natyralizuar, imigrantë për motive të tjera. Numri i përgjithshëm i shtetasve të huaj që qëndrojnë në Shqipëri ka mbetur përafërsisht në nivelin 0,45% të popullsisë në Shqipëri. Numri dhe origjina e imigrantëve të rregullt nuk ka shënuar ndryshime të theksuara.

Numri i përgjithshëm i imigrantëve u rrit me 7.5% nga viti 2019 në 2020, po ashtu nga 2020-ta në 2021-shin u rrit me 28.2%, ndërkohë që nga viti 2021–2022 numri u ul me 24.2%, ndërkohë që numri i përgjithshëm nga viti 2019–2022 është rritur me 11.5%. Sa i takon gjinisë, kontinentin evropian e dominon gjinia mashkullore, duke përfaqësuar një numër pothuajse dy herë më të madh se sa femrat. Lidhur me kontinentin aziatik, shihet një balancë më e madhe gjinore deri në vitin 2021, ndërkohë që më 2022-shin, po ashtu numri i meshkujve imigrantë është rritur dy herë më shumë se sa i femrave. Sa i takon kontinentit amerikan dhe evropian, numri i imigrantëve femra dhe meshkuj është pothuajse i njëjtë përgjatë gjithë viteve.

Figura A.2.1.1 Shtetas të huaj me qëndrim në Shqipëri sipas origjinës dhe gjinisë




Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, 2023

Në vitin 2019: rreth 81,5% të imigrantëve e përbënin ata me origjinë evropiane, 5,6% ishin nga Azia, 6,9% nga Amerika, 5,4% nga Afrika dhe 0,6% nga Australia. Në vitin 2020: 88% të imigrantëve e përbënin ata me origjinë evropiane, 4% aziatike, 3,3% amerikane, 4,2% afrikane dhe 0,4 australiane. Në vitin 2021, imigrimi nga vendet evropiane zinte 84,3%, ndërkohë që 3,6% vinin nga kontinenti amerikan, 8,6% nga kontinenti aziatik, 4,2% nga shtetet afrikane dhe 0,4 nga shtetet australiane. Më tej, në vitin 2022, 67,4%



të imigrantëve e përbënin ata me origjinë evropiane, 22,4% aziatike, 4,2% amerikane, 5,6% afrikane dhe 0,5 australiane.

Figura A.2.1.2 Shtetas të huaj me qëndrim në Shqipëri sipas origjinës



Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, 2023


Nga imigrantët evropianë për vitin 2019: rreth 41.2% ishin italianë, 17.7% ishin turq, 23.7% ishin nga Kosova. Rreth 72.9% e imigrantëve aziatikë ishin nga Kina 23.7% nga India. Imigrantët nga SHBA-ja përbënin 81.3% të emigrantëve të kontinentit amerikan, ndërsa kanadezët vetëm 16.9%. Nga vendet afrikane, për vitin 2019, 41.9% ishin nga Siria dhe 28.8% nga Egjipti.

Për vitin 2020 nga imigrantët evropianë: rreth 31.9% ishin italianë, 21.8% ishin turq, 26.6% ishin nga Kosova. Rreth 59.7% e imigrantëve aziatikë ishin nga Kina 33.6% nga India. Imigrantët nga SHBA-ja përbënin 85% të emigrantëve të kontinentit amerikan, ndërsa kanadezët vetëm 15%. Nga vendet afrikane: 41.7% ishin nga Egjipti dhe 32.7% nga Siria.

Për vitin 2021, nga imigrantët evropianë: rreth 32.7% ishin italianë, 22.4% ishin turq, 25.7% ishin nga Kosova. Rreth 52.8% e imigrantëve aziatikë ishin nga India dhe 39.7% nga Kina. Imigrantët nga SHBA-ja përbënin 81.8% të emigrantëve të kontinentit amerikan, kurse kanadezët vetëm 18.2%. Nga vendet afrikane, 37.3% ishin nga Egjipti dhe 27.7% nga Siria.

Ndërsa për vitin 2022, nga imigrantët evropianë, rreth 33.3% ishin italianë, 12.9% ishin turq, 34.7% ishin nga Kosova. Rreth 58.1% e imigrantëve aziatikë ishin nga India dhe 21% nga Kina. Imigrantët nga SHBA-ja përbënin 73.3% të emigrantëve të kontinentit amerikan, ndërsa kanadezët 26.7%, duke shënuar një rritje nga vitet e mëparshme. Nga vendet afrikane, 41.1% ishin nga Egjipti dhe 27.7% nga Siria.

Figura A.2.1.3 Të huajt me qëndrim në Shqipëri sipas grup-moshës



Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, 2023



Sa u takon grup-moshave të imigrantëve në Shqipëri, shihet se për vitin 2019 ka dominuar grup-mosha 40–44 vjeç, e cila po ashtu është grup-mosha më e përhapur për 2020-n, ndërkohë që për 2021-shin ka dominuar mosha 50–54 vjeç dhe për vitin 2022 mosha 30–34 vjeç.

Tabela A.2.1.1 Shtetasit e huaj nga Afrika dhe Azia me qëndrim në Shqipëri


Shteti	2019	2020	2021	2022
Algjeri	3	4	7	15
Siri	308	157	145	171
Marok	8	4	5	8
Afganistan	3	2	8	111
Palestinë	46	15	13	23
Tunizi	9	8	10	12
Pakistan	8	7	8	23
Jemen	18	11	5	14
Guinea	1	2	2	1
Ghana	4	-	7	22
Sudan	24	16	22	4
Eritrea	-	-	1	1
Uganda	6	2	3	1
Libi	46	27	30	26
Indi	77	45	113	373
Irak	26	9	5	6
Iran	24	25	106	60
Turqi	806	745	954	764
Gjithsej	1417	1079	1444	1635

Burimi: FER-TIMS në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, 2023

Gjatë 2019–2022: 78.3% e imigrantëve të rregullt ishin evropianë, 10.4% afrikanë, 5.6% aziatikë dhe 5.5% amerikanë. Përgjatë 2019–2022, numri i imigrantëve është rritur me 21.2%. Nga 2019 në 2020 numri i imigrantëve ka pësuar një rënie prej 35%, ndërkohë që 2020–2021 është rritur me 22% dhe më pas nga 2021–2022 është rritur serish 33.8%.

Sipas motiveve të qëndrimit, numrin me të madh të të huajve e përbëjnë ata që qëndrojnë në Shqipëri për arsye punësimi, me afat mbi 12 muaj. Ata janë kryesisht meshkuj dhe përqendrohen më së shumti në qytetin e Tiranës.

Figura A.2.1.3 Lejet e qëndrimit sipas motivit




Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, 2023

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në tregun shqiptar të punës ka ardhur në rritje. Tirana ka numrin më të madh të të huajve që punojnë, ndjekur nga qarqet e Durrësit dhe të Vlorës. Të huajt punojnë kryesisht si punëmarrës dhe një kategori më e vogël si të vetëpunësuar, dhe/apo si investitorë. Punonjësit me shtetësi të huaj hyjnë në tregun vendës të punës në ata sektorë ku punëdhënësit nuk arrijnë të gjejnë fuqi punëtore në vend. Sektorët kryesorë janë teknologjia e informacionit dhe e komunikimit, industria përpunuese dhe nxjerrëse dhe tregtia me shumicë e pakicë, sektorët e ndërtimit dhe e aktiviteteve të shërbimeve të tjera.

Nëse e zbërthejmë sipas gjinisë, në të gjitha vitet duket se mbizotërojnë lejet e qëndrimit të lëshuara për meshkujt krahasuar me femrat, siç shihet në figurën e mëposhtme.

Figura A.2.1.4 Lejet e qëndrimit për të huajt sipas gjinisë




Burimi: Sistemi FER-TIMS në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, 2023

Sipas të dhënave të Regjistrimit Elektronik për të Huajt (FER), gjatë vitit 2022, u pranuan dhe shqyrtuan 10 143 kërkesa për leje qëndrimi nga shtetasit e huaj. Të dhënat sipas grup-moshave tregojnë se ka një rritje të të huajve me qëndrim në vend mbi moshën 30–39 vjeç.

Figura e mëposhtme paraqet dinamikën e kërkesave për leje qëndrimi në Shqipëri gjatë viteve 2019–2022, sipas rajoneve.


Figura A.2.1.5 Kërkesat për leje qëndrimit nga shtetasit e huaj, sipas qarkut



Burimi: Regjistrit Elektronik për të Huajt (FER), 2023

Siç vërehet nga figura 2.1.6, gjatë vitit 2021, u paraqitën dhe u përpunuan më shumë kërkesa për leje qëndrimi krahasuar me vitet 2019, 2020 dhe 2022. Ashtu si shumica e personave me leje qëndrimi, edhe pjesa më e madhe e aplikantëve të rinj janë përqendruar në Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Vlorë.

Figura A.2.1.6 Shtetas ukrainas të trajtuar me leje qëndrimi në RSH



Burimi:


Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, 2023

Lidhur me shtetasit ukrainas, të cilët janë trajtuar me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, siç vërehet në figurën e mësipërme, numri është rritur nga 17 në vitin 2019, në 26 në vitin 2022.

A.2.1.2 Studentët e huaj në institucionet shqiptare të arsimit të lartë

Numri i studentëve të huaj në institucionet shqiptare të arsimit të lartë ka pësuar një rënie me 10.7% në periudhën 2019–2022, krahasuar me vitin akademik 2015–2018. Përkatësisht, nga 2019 numri është rritur me 13%, ndërkohë që në vitin pasardhës akademik numri ra me 7.2%, dhe vazhdoi të bjerë vitin pasardhës me 10.9%, ndërsa për vitin akademik 2022–2023 numri i studentëve të huaj u rrit me 7.3%


Figura A.2.1.2.1 Studentët e huaj në institucionet shqiptare të arsimit të lartë



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, 2023

Shumica e këtyre studentëve vijnë nga popullsia shqiptare në vendet e rajonit, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut, ndjekur nga shtetasit turq dhe italianë. Për vitin akademik 2018–2019, shumica e të huajve që studiojnë në Shqipëri ishin nga Italia me 31.4%, ndjekur nga Kosova me 26.7%, ndërkohë që 31.7% ishin nga vende të tjera. Sa i takon vitit akademik 2019–2020 studentët italianë përbëjnë sërish pjesën më të madhe në 33.5%, ndjekur nga kosovarët me 29.6% dhe 28.5% nga vende të tjera. Përgjatë viteve akademike 2020–2023 numri i studentëve italianë që studiojnë në Shqipëri ka arritur 51.5% të studentëve të huaj, 45.8% për 2021–2022 dhe 38.4% për 2020–2021. Ndërkohë që numri i studentëve kosovarë në Shqipëri është ulur, nga 25.3% në 2020–2021, në 20.6% në 2021–2022 dhe në 18.9% në 2022–2023.

Figura A.2.1.2.1.2 Të huajt që studiojnë në Shqipëri



Burimi: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, 2023

A.2.1.2 Flukset e përziera migratore

Shqipëria është prekur, gjithashtu, nga flukset e përziera migratore, të cilat përbëhen, ndër të tjera, nga refugjatët dhe azilkërkuesit, migrantët, viktimat e trafikimit, të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë, si dhe personat pa shtetësi. Disa prej tyre bëjnë pjesë në më shumë sesa një nga këto kategori. Këta persona kanë shtetësi të ndryshme, shumica prej të cilëve janë sirianë dhe afganë dhe, shpesh, futen në vend pa leje hyrjeje. Në të shumtën e rasteve, këta migrantë janë në një gjendje të caktuar vështirësie, për shkak të situatës në vendet e tyre të origjinës nga të cilat janë larguar, për shkak të kushteve të vështira ose shfrytëzimit dhe abuzimit të pësuar përgjatë udhëtimit³. Sidoqoftë, këto flukse kalojnë kryesisht tranzit në Shqipëri, përpara se të hyjnë në vendet e BE-së.

A.2.1.2.1 Trajtimi i azilkërkuesve

Në aspektin e trajtimit dhe pritjes së kategorisë së azilkërkuesve, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Konventën e Gjenevës të vitit 1951 dhe protokollin e vitit 1967 për statusin e refugjatëve. Shqipëria ka parashikuar me ligj “Parimin e moskthimit”, i cili përcaktohet në nenin 6, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij parimi, Shqipëria njeh dhe respekton detyrimin e autoriteteve për të mos kthyer a prapësuar, ekstraduar apo larguar jashtë territorit të saj personat që kanë përfituar apo kërkuar të drejtën e azilit apo të formave të tjera të mbrojtjes për këto raste. Nga të dhënat që disponon autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët nuk ka asnjë rast dëbimi për shtetas, të cilët kanë rezultuar azilkërkues dhe kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë. Dinamika e të huajve me mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri për periudhën 2019–2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela A.2.1.2.1 Të huajt me mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri

	2019	2020	2021	2022
Refugjat	1	-	-	-
Mbrojtje plotësuese	23	4	7	24
Mbrojtje e përkohshme	-	-	230	544
Gjithsej	24	4	237	568

Burimi: Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, 2023

³ Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm, 2017–2021.



Për periudhën 2019–2022, vërehet një rritje e vullshme e numrit të azilkërkuesve, që arrin pikën më të lartë në vitin 2022 me 568 kërkesa, shumica prej të cilave janë për mbrojtje të përkohshme. Ndërkohë që për tri vitet e fundit nuk ka shtetas që kanë marrë statusin e refugjatit dhe duket që gjatë 2022 numri i individëve me mbrojtje plotësuese është rritur krahasimisht me 2020-n dhe 2021-shin.

Vlen të theksohet se vendimet e pezullimit janë vendime të ndërmjetme të marra nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, kryesisht për ato raste kur azilkërkuesit lënë vendin, pasi kanë filluar procedurat e azilit dhe i ndërpresin ato (zakonisht, disa ditë pas paraqitjes së kërkesës). Numri i pezullimeve ka rënë ndjeshëm nga viti 2019 në vitin 2022. Shtetasit të cilëve iu është pezulluar azilkërkimi më së shumti janë ata Sirianë. Viti i cili ka më pak vendime pezullimi është 2021 me vetëm 2 pezullime.

Tabela A.2.1.2.2 Vendime pezullimi të azilkërkimit sipas shtetësisë

Shtetësia	2019	2020	2021	2022
Ukraine	-	-	-	12
Siri	27	4	-	2
Afganistan	-	-	-	2
Algjeri	1	2	-	1
Jemen	1	-	-	-
Marok	8	2	-	1
Turqi	1	-	1	-
Irak	4	-	-	-
Shtete të tjera sipas databazës	3	2	-	-
Gjithsej	45	10	1	18

Burimi: Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, 2023

Tabela e mëposhtme paraqet me hollësi të dhëna plotësuese mbi llojet e vendimeve të marra për periudhën 2019–2022 nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Shqipëri, të cilat përfshijnë vendime refuzimi, vendime revokimi, vendime pushimi. Gjatë vitit 2019 janë marrë 51 vendime gjithsej, nga të cilat 49 kanë qenë vendime pushimi. Për vitin 2020 vazhdon i njëjti trend me shumicën e vendimeve ato të pushimit, pavarësisht se numri i përgjithshëm është më i vogël, 20 vendime gjithsej. Sa i takon vitit 2021 ka pasur vetëm 3 vendime dhe për vitin 2022 ka pasur vetëm vendime pushimi, 18 vendime.

Tabela A.2.1.2.3 Llojet e vendimeve të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët

	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Refuzime	1	4	1	-
Revokime	1	4	1	-
Pushime	49	12	1	18
Gjithsej	51	20	3	18

Burimi: Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, 2023

A.2.1.3.2 Shqipëria si vend tranziti

Gjatë vitit 2019 u ndaluan në kufi një numër prej 11 890 shtetasish të huaj, nga të cilët, 70% janë kapur në zonë kufitare, 0.3% në PKK dhe 29% në territor. Më 2020-n ky numër u rrit me 45.2% (18 835 persona të ndaluar), nga të cilët: 73% u kapën në zonë kufitare, 0.9% në PKK dhe 26.1% na territor. Më 2021-shin numri i personave të ndaluar, krahasuar me 2020-n ra me 1.8%, nga të cilët: 70.6% u kapën në zonë kufitare, 1.2% në PKK dhe 28.2% në territor. Sa i takon 2022-shit, numri total ra me 40.5% krahasuar me 2021-shin, në të njëjtën kohë është vërejtur një ndryshim sa i takon pikës ku ndalohen të huajt, në vitet paraardhëse të huajt janë ndaluar kryesisht në zonë kufitare dhe në territor, ndërkohë që më 2022-shin 54.3% janë ndaluar në PKK, 42.8% në territor dhe vetëm 2.9% në zonë kufitare. Nga viti 2019 në vitin 2022 numri i të huajve të ndaluar është rritur me 2.7%.



Tabela A.2.1.2.2.1 Të huaj të ndaluar

	2019	2020	2021	2022
Në zonë kufitare	8417	13746	13067	352
Në PKK	38	171	218	6632
Në territor	3435	4918	5211	5232
Gjithsej	11890	18835	18496	12216

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, 2023

Numri i shtetasve të huaj që janë ndaluar duke hyrë në mënyrë të parregullt në territorin shqiptar nga Greqia ka pësuar një rritje në periudhën 2019–2022 me 21%, ndërkohë që përgjatë viteve ka qenë zona ku shqiptarët janë ndaluar më së shumti, me 70% të ndalimeve më 2019-n, 94% më 2020-n, 92% në 2021-shin dhe 84% më 2022-shin. Sa i takon kufirin me Malin e Zi dhe Kosovën, numri i përgjithshëm ka rënë me 41%, numri i të kapurve në territor ka rënë me 94%, ndërkohë që numri i shqiptarëve të ndaluar në kufirin detar ka pësuar ngritje në vitet 2020–2021 për të rënë sërish më 2022-shin.

Tabela A.2.1.2.2.2 Të huajt e ndaluar në kufi ose në territorin shqiptar

	Në kufi me Greqinë	Në kufi me Malin e Zi/Kosovën	Në territor	Në kufirin detar
2019	8324	2062	1442	62
2020	16776	118	434	504
2021	17189	609	542	156
2022	10281	1347	519	69

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, 2023

Ajo çfarë konstatohet është se të ndaluarit nuk kanë preferuar të kërkojnë azil apo të qëndrojnë në Shqipëri në momentin e ndalimit nga shërbimet e kufirit dhe migracionit, por kanë deklaruar se duan të vazhdojnë rrugën drejt vendeve të BE-së.

Tabela A.2.1.2.2.3 Të huajt nga vendet e treta sipas shtetësisë

	2019	2020	2021	2022
Sirianë	3294	9836	10288	5314
Bangladeshi	9	239	1198	1564
Afganë	541	2374	2369	1325
Pakistanezë	491	287	478	1114
Somalez	36	18	87	574
Marokenë	1631	1557	1157	484
Iranian	186	510	179	340
Palestinez	453	952	540	299
Iraken	3531	1348	650	276
Egjiptian	160	364	385	222
Nepali	41	76	149	169
Indian	15	18	108	102
Algjerianë	1016	360	226	85
Eritreas	10	1	22	76
Jemenas	77	110	120	63
Sudanez	22	25	140	42
Kuba	0	7	15	38
Libian	167	537	172	29
Tunizian	66	49	41	15
Kuvajt	36	19	15	14
Mauritanez	3	6	22	13
Turk	45	27	50	10
Kinez	0	0	1	9
Togo	0	5	10	6
Nigerian	0	1	4	5




Kameruni	0	3	2	5
Guinea	1	6	9	5
Kurdistani	0	15	4	4
Libanez	12	37	11	2
Mali	1	1	4	2
Haitit	6	0	0	2
Sri Lanka	0	0	0	2
Gambia	0	0	0	2
Etiopian	1	0	0	1
Mayanmar Burma	1	2	0	1
Rus	0	0	0	1
Uganda	0	0	0	1
Ghana	0	9	1	0
Kongolez	1	21	27	0
Uzbekistan	1	0	1	0
Tibet	10	0	0	0
Saharaja Perëndimore	6	11	2	0
Çadi	0	0	6	0
Rep. Qen. Afrikane	0	0	2	0
Grek	0	0	1	0
Bregu i Fildishtë	0	3	0	0
Jordania	0	1	0	0
Kashmir	6	0	0	0
Ekuador	4	0	0	0
Azerbajxhan	2	0	0	0
Gjermani	2	0	0	0
Serb	2	0	0	0
Sierra Leone – Afrikë	2	0	0	0
Nimari	2	0	0	0
Totali	11890	18835	18496	12216
<i>Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, 2023</i>				

Lidhur me shtetësinë e të huajve nga vendet e treta, përgjithësisht kanë mbizotëruar shtetasit e Sirisë, Irakut dhe Afganit. Pavarësisht kësaj ka pasur po ashtu një numër të konsiderueshëm të shtetasve nga Pakistani, Bangladeshi dhe Maroku. Lidhur me numrin total të të huajve nga vendet e treta, në vitin 2019 ishte 11 890, duke u rritur me 45.2% më 2020-n. Më 2021-shin numri i përgjithshëm pësoi një rënie prej 1.8% për të rënë sërish më 2022-shin me 40.8%, duke u afruar kështu me numrin e përgjithshëm në vitin 2019, më një diferencë prej vetëm 2.7% më shumë më 2022-shin se sa më 2019-n.

Për shtetasit e huaj nga vendet e treta në territor është zbatuar procedura e largimit mbi baza vullnetare dhe një pjesë e tyre janë trajtuar në Qendrën e Mbyllur Pritëse, duke vijuar me procedurat e kthimit mbështetur mbi marrëveshjet dypalëshe mes Shqipërisë dhe vendeve të origjinës/tranzitit. Numri i personave të trajtuar në Qendrën e Mbyllur për vitet 2019 është 56, duke pësuar rënie më 2020-n me 39 persona, më pas në 2021 numri është rritur në 72 persona dhe për 2022 numri ka qenë 65 persona, siç paraqitet në figurën e mëposhtme:



Figura A.2.1.2.2.1 Të huaj të ndaluar në QMH



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, 2023

Lidhur me të huajt, të cilëve iu është refuzuar hyrja në PKK përgjatë dy viteve të para (2019–2022), pjesës më të madhe të të huajve iu është refuzuar hyrja në kufirin tokësor (58.1% për 2019–n dhe 58.6% për 2020–n), ndërkohë që për vitin 2021 dhe 2022 pjesës dërrmuese të të huajve iu është refuzuar hyrja në kufirin ajror (90.2% për 2021 dhe 98% për 2022). Një numër shumë i vogël të huajsh është refuzuar në kufiri detar për të gjithë vitet. Numri i përgjithshëm i të huajve të cilëve iu është refuzuar hyrja, është rritur ndjeshëm përgjatë katërvjeçarit të fundit. Nga viti 2019 më 2020–n është rritur me 63.7%, për të pësuar një rënie me 40.2% nga 2020–ta më 2021–shin dhe për t'u rritur në mënyrë drastike nga 2021–shi më 2022–shin, me 115.5%. Mesatarisht, numri është rritur me 46.3% të huaj të refuzuar në vit.

Tabela A.2.1.2.2.4 Të huajt e refuzuar në hyrje sipas llojit të PKK

	2019	2020	2021	2022
Tokësor	260	507	54	11
Ajror	180	348	519	2166
Detar	7	10	2	7
Total	447	865	575	2148

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, 2023

Përgjithësisht, refuzimet kanë ndodhur për arsye të dokumentacionit të pavlefshëm, mungesës së mjeteve financiare dhe mungesës së vizës, ndërkohë që sa u takon njoftimeve në sistem, nuk ka pasur asnjë rast. Numri i përgjithshëm i të huajve të refuzuar në hyrje të kufirit ka pësuar një rritje prej 131 më 2022–shin krahasuar më 2019–n, ose një rritje mesatare gjatë katërvjeçarit prej 72%.

Tabela A.2.1.2.2.5 Të huajt e refuzuar në hyrje sipas motivit

	2019	2020	2021	2022
Dokumentacioni pavlefshëm, mungesë vize	112	304	25	35
Nuk ka vizë	86	82	26	36
Tejkalim afatit qëndrimi	87	15	3	236
Njoftim në sistem	0	0	0	0
Mungesë e mjeteve financiare	127	399	512	1806
Nuk plotëson kushtet e qëndrimit në RSH	35	65	9	35
Të tjera	447	865	575	2148

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, 2023

Në vitin 2018 u nënshkruan marrëveshje rripranimit (për kthimin e migrantëve të parregullt që nuk kanë të drejtë të qëndrojnë në Shqipëri) me Marokun, Afganistanin, Irakun dhe Iranin. Shqipëria ka protokolle zbatimit me 12 shtete të BE-së. Protokollin e zbatimit me Spanjën u nënshkrua në maj 2018. Ndërkohë, negociatat për marrëveshjet e rripranimit po vazhdojnë me Rusinë.



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kthehen nga policitë e vendeve të tjera në kufi u nënshtrohen procedurave të posaçme të pritjes, intervistimit dhe, më pas, përzgjedhjes. Një nga qëllimet e procesit të përzgjedhjes është edhe vlerësimi i dobësive dhe i nevojave apo i treguesve të trafikimit të qenieve njerëzore, bazuar në procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe të viktimave të mundshme të trafikimit (miratuar me VKM nr. 449, datë 29.8.2018). Gjatë periudhës 1 janar–31 dhjetor 2022 janë evidentuar 112 VT/VMT (femra, meshkuj, të rritur, të mitur, shqiptarë apo të huaj), nga të cilët 109 janë viktimat e mundshme trafikimi dhe 3 janë viktimat trafikimi, 31 janë meshkuj dhe 81 janë femra, 109 janë shqiptarë dhe 3 është e huaj.

Tabela A.2.1.2.2.5 Statistikat për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit

	2019	2020	2021	2022
<i>Sipas statusit</i>				
VT	7	5	5	3
VMT	96	81	154	109
<i>Sipas gjinisë</i>				
Femër	80	62	99	81
Mashkull	23	24	60	31
<i>Sipas kombësisë</i>				
Shqiptar	97	83	156	109
Të huaj	6	3	3	3

Burimi: Ministria e Brendshme, 2023

B. NDIKIMI I MIGRACIONIT NË EKONOMINË DHE SHOQËRINË SHQIPTARE

Nga pikëpamja e ndikimit të migracionit duhet theksuar se tregu i punës në Shqipëri ndikon në vazhdimin e flukseve migratore nga Shqipëria drejt vendeve me tregje pune më të zhvilluara. Disa nga tiparet e dobësisë së punës janë: niveli i lartë i papunësisë te të rinjtë; shkalla e lartë e papunësisë afatgjatë; tregu i punës mbetet refraktar e joelastik edhe ndaj të rinjve që shkollohen; shpërndarja e pabarabartë e papunësisë; papunësia e lartë në fshat, veçanërisht në bujqësi; informaliteti në tregun e punës etj. Disa prej karakteristikave të mësipërme kanë filluar të zbuten, por një pjesë e tyre ka pasur ndikim edhe në periudhën 2019–2022, duke nxitur flukset migratore. Punësimi informal lidhet me të ardhurat e ulëta dhe varfërinë dhe inkurajon flukset migratore. Qeveria shqiptare vazhdon t'i japë përparësi zhvillimit ekonomik përmes nxitjes së investimeve të huaja direkte dhe mbështetjes së ndërmarrjeve të huaja të përbashkëta, të cilat ndihmojnë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe shkurajimin e flukseve migratore nga vendi.

B.1 Migracioni dhe zhvillimi demografik

B.1.1 Popullsia e Shqipërisë

Sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, numri i shtetasve shqiptarë është çdo vit në rritje. Struktura e popullsisë sipas qarqeve për periudhën 2019–2022, paraqitet si më poshtë:

Tabela B.1.1 Struktura e popullsisë sipas qarkut

	2019	2020	2021	2022
Berat	229 709	229 354	227 778	227 524
Dibër	174 493	173 918	171 781	171 480
Durrës	457 910	460 320	467 041	471 440
Elbasan	447 304	447 566	448 123	449 316
Fier	508 745	509 099	508 872	510 159
Gjirokastrë	148 250	147 870	145 857	145 194
Korçë	350 376	349 905	347 867	347 376
Kukës	110 067	109 972	110 117	111 094
Lezhë	224 596	224 801	225 387	226 595
Shkodër	344 255	344 412	344 676	346 083
Tiranë	1 146 821	1 153 250	1 174 864	1 190 977
Vlorë	387 564	387 855	387 903	388 906
Gjithsej	4 530 090	4 538 322	4 560 266	4 586 144

Burimi: Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, 2023

Sa i përket gjinisë, raporti femra-meshkuj mbetet pak a shumë i njëjtë ndër vite dhe shënon një rritje totale pozitive çdo vit.

Tabela B.1.2 Struktura e popullsisë sipas qarkut dhe gjinisë

	2019		2020		2021		2022	
	F	M	F	M	F	M	F	M
Berat	111,342	118,367	110,987	117,989	110,409	117,369	110,298	117,226
Dibër	83,589	90,904	83,014	90,574	82,031	89,750	81,816	89,664
Durrës	225,472	232,438	227,882	234,570	230,261	236,780	232,612	238,828
Elbasan	217,431	229,873	217,693	230,232	217,760	230,363	218,386	230,930
Fier	245,702	263,043	246,056	262,983	246,176	262,696	246,833	263,326
Gjirokastrë	72,984	75,266	72,604	74,874	71,824	74,033	71,531	73,663
Korçë	173,242	177,134	172,771	176,625	172,125	175,742	171,964	175,412
Kukës	53,340	56,727	53,245	56,789	53,220	56,897	53,591	57,503
Lezhë	109,442	115,154	109,647	115,220	109,970	115,417	110,439	116,156
Shkodër	168,835	175,420	168,992	175,254	169,254	175,422	170,002	176,081
Tiranë	572,225	574,596	578,654	579,755	587,552	587,312	595,813	595,164
Vlorë	191,154	196,410	191,445	196,604	191,469	196,434	191,924	196,982
Gjithsej	2,224,758	2,305,332	2,232,990	2,311,469	2,242,051	2,318,215	2,255,209	2,330,935

Burimi: Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, Tiranë, 2023


B.1.2 Migrimi i jashtëm në pakësimin e moderuar të popullsisë

Popullsia banuese në Shqipëri është më pak se 3 milionë dhe, që prej vitit 2001, rezulton me rritje negative. Ndryshimet në popullsi vijnë si rezultat i dy komponentëve: shtesës natyrore të popullsisë dhe migracionit neto.

Numri i emigrantëve shqiptarë për vitin 2022 ishte rreth 46 460, ndërsa numri i imigrantëve që kanë hyrë në Shqipëri ishte rreth 13 963⁴. Migracioni ndërkombëtar vazhdon të jetë një faktor i rëndësishëm për zhvillimet demografike të vendit. Mbizotërimi i të larguarve në raport me të ardhurit ka një ndikim të menjëhershëm në numrin e popullsisë. Gjithashtu, migrimi i femrave në moshë pune dhe riprodhuese ndikon në treguesit më të rëndësishëm demografikë, siç është rënia e lindshmërisë.

Rënia e popullsisë është vërejtur edhe gjatë tri viteve në fundit, pavarësisht së ritmi i rënies është më i ulët. Gjatë periudhës 2019–2022, popullsia u zvogëlua me rreth 14 mijë banorë, me një ndryshim mesatar vjetor të popullsisë prej -3,01%. Kjo situatë vjen si rrjedhojë e uljes së shtesës natyrore, kryesisht për shkak të rënies së numrit të lindjeve, ndërkohë që nuk vërehet shumë ndryshim në raport me vdekjet. Nga ana tjetër, ka një rritje në vlerë absolute të migracionit neto, nga -23082 në vitin 2019, në -32497 në vitin 2022.

Figura B.1.2.1 Treguesit demografikë të popullsisë



Burimi: INSTAT, 2023


⁴ Instituti i Statistikave. (2022, gusht '22). *Migracioni dhe Integrimi I Migrantëve*. INSTAT:

<https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/migracioni-dhe-integrimi-i-migrant%C3%ABve/#tab2>

Koeficienti i migracionit tregon numrin e imigrantëve që kthehen apo hyjnë në një vendbanim për 1 000 banorë në një vit të dhënë. Në vitin 2022, ky tregues erdhi duke rënë, nga 7,3 imigrantë për mijë banorë që vlerësohej në vitin 2019, në 5,0 imigrantë për mijë banorë.

Koeficienti i emigracionit tregon numrin e emigrantëve që largohen nga një vendbanim për 1 000 banorë të atij vendbanimi në një vit të dhënë. Ky tregues erdhi duke u rritur, nga 15,4 më 2019-n, në 16,7 më 2022-shin. Migracioni neto shpreh efektin neto të imigrantëve dhe të emigrantëve mbi popullsinë e një vendi. Ky tregues vazhdon të ndikojë negativisht në bilancin e popullsisë së Shqipërisë, i cili shënoi një rënie nga -8,1 persona për mijë banorë më 2019-n, në -11,7 persona për mijë banorë më 2022-n. Kjo rënie i atribuohet më së shumti rritjes së fluksit të emigrantëve.

Figura B.1.2.2 Dinamikat e migracionit



Burimi: INSTAT, 2023

B.1.3. Ndikimi i emigrimit në raportet e varësisë moshore dhe në strukturën e popullsisë


Në vitin 2022, në popullsinë e Shqipërisë, të rinjtë (0–14 vjeç) zinin 16,3% të popullsisë, popullsia në moshë pune (15–64 vjeç) llogaritet në rreth dy të tretat (68,0%) e popullsisë, ndërsa popullsia mbi 65 vjeç zinte rreth 15,7% të popullsisë së vendit. Për shkak të moshës së re të flukseve migratore, pesha që zënë të moshuarit mbi 65 vjeç në popullsinë e përgjithshme të vendit gjatë katër vjetëve të fundit ka shënuar prirje rritëse. Në këtë mënyrë, emigrimi ndërkombëtar, flukset e të cilit vazhdojnë të përfshijnë një popullsi relativisht të re, vazhdon të ndikojë në plakjen e popullsisë, krahas uljes së lindshmërisë dhe të rritjes së jetëgjatësisë.

Një tregues i strukturës së popullsisë është raporti i varësisë moshore. Varësia moshore shfaqet në dy aspekte: i. varësia e popullsisë së moshuar; dhe ii. varësia e popullsisë së re. Raporti i varësisë së të moshuarve llogaritet si raport i popullsisë 65 vjeç e lart ndaj popullsisë në moshë pune 15–64 vjeç. Për vitin 2022, ky raport në Shqipëri ishte 23,1% kundrejt 20,5% në vitin 2019. Raporti në fjalë po shfaq një prirje rritëse me kalimin e viteve, e cila dëshmohet nga një peshë më e madhe e popullsisë së moshuar kundrejt popullsisë në moshë pune. Këtu ka ndikim edhe fakti që flukset migratore mbizotërohen nga moshat e reja.

Raporti i varësisë së të rinjve llogaritet si raport i popullsisë 0–14 vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15–64 vjeç. Ky raport për vitin 2022 ishte 24,0% kundrejt 25,1% në vitin 2019. Pra, koeficienti i varësisë së të moshuarve vjen duke u rritur, ndërsa koeficienti i varësisë së të rinjve vjen duke u zvogëluar.

Këta dy tregues përbëjnë dy anë të së njëjtës medalje, që është dukuria e moshimit të popullsisë dhe të dyja proceset ndodhin për të njëjtën arsye, mbizotërimi i moshave të reja në flukset e reja migratore.

Figura B.1.3.1 Popullsia sipas tri grup-moshave kryesore



Burimi INSTAT, 2023


B.2 Migracioni dhe zhvillimi ekonomik

Rubrika në vijim trajton disa prej aspekteve të lidhjes midis migracionit dhe zhvillimit ekonomik.

B.2.1. Dërgesat në para të emigrantëve si pjesë e investimeve të huaja direkte

Dërgesat në para të emigrantëve konsiderohen si element përbërës i investimeve të huaja direkte. Numri i lartë i emigrantëve ka prodhuar flukse të konsiderueshme të dërgesave valutore ndër vite. Në nivelin makroekonomik, dërgesat nga emigrantët në Shqipëri përbëjnë një ndër të ardhurat më të mëdha valutore që vijnë nga jashtë, si dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të bilancit të pagesave, si burim i jashtëzakonshëm financimi për ekonominë vendëse. Këto të ardhurat përsuan një rënie të lehtë në periudhën pas krizës globale, pa cenuar kontributin e rëndësishëm të këtij zëri, në kuadrin makroekonomik të vendit. Për periudhën 2019–2022, të ardhurat nga emigrantët vlerësohen mesatarisht në rreth 742 milionë euro në vit. Gjatë këtyre viteve, ato kanë njohur rritje, duke arritur në rreth 833 milionë euro për vitin 2022.

Figura B.2.1.1 Dinamikat e dërgesave në euro nga emigrantë shqiptarë



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2023

Të ardhurat nga emigrantët janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave të përgjithshme të familjeve, që mbështetin shpenzimet e konsumit dhe investimet familjare. Sidoqoftë, rritja e flukseve migratore ndër vite pritet të japë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në reduktimin e dërgesave, ndaj përdorimi sa më efektiv i tyre dhe lidhja me investimet mbetet përparësi për zhvillimin e ekonomive lokale.

B.2.2 Rritja ekonomike, mirëqenia dhe flukset migratore

Rritja reale e PBB-së është ndër treguesit më të rëndësishëm të llogarive kombëtare. Gjatë vitit 2019, ekonomia shqiptare shënoi një rritje reale prej 2.09, ndërsa, në vitin 2020, rritja ekonomike shënoi rënie me -3.3. Ndërkohë që në dyja vitet pasuese është parë një rritje e konsiderueshme, më 2021-shin me 8.91 dhe më 2022-shin me 4.86. Gjatë vitit 2019, kontributi kryesor në rritjen ekonomike erdhi nga tregtia, transporti, aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (0.72), administratat publike (0.42) dhe aktivitetet shkencore (0.4). Për vitin 2020 të gjithë sektorët pësuan një rënie, ku industria kryesor me -0.95 dhe më pas aktivitetet shkencore me -0.64. Në vitin 2021 është parë një rritje në shumicën e sektorëve, kryesisht, në industrinë e transportit me 1.62, në industrinë e ndërtimit me 1.61 dhe në sektorin e industrisë me 1.17.

B.2.3 Migracioni dhe tregu i punës

B.2.3.1 Ndikimi i tregut të punës në flukset migratore

Tregu i punës në Shqipëri është ende i dobët dhe ndikon në vazhdimin e flukseve migratore nga Shqipëria drejt vendeve me tregje pune më të zhvilluara. Popullsia e Shqipërisë ka shfaqur shenja moshimi. Megjithatë, popullsia e Shqipërisë moshohet me ritme më të ulëta se popullsia e BE-së. Moshja mesatare e popullsisë ka ardhur në rritje, nga 36,7 vjeç në vitin 2019, në 38,2 vjeç në vitin 2022. Në piramidën e popullsisë shtohet popullsia mbi 65 vjeç, ndërsa grup-mosha nën 15 vjeç pakësohet.

Tabela B.2.3.1 Bilanci i forcave të punës

	2019	2020	2021	2022
Mosha mesatare e popullsisë				
Forca e punës	60.4	59.5	59.8	62.4

Burimi: INSTAT, 2023

Lidhur me bilancin e forcave të punës, përgjatë viteve shihet një rritje nga 60.4% në 62.4%.

Tabela B.2.3.2 Numri i të papunëve sipas llojit të papunësisë

	2019	2020	2021	2022
Të papunë afatgjatë	7.3	7.0	7.2	7.3
Të papunë që përfitojnë pagesë papunësie	2870	4744	4679	2552
Të papunë gjithsej	11.5	11.7	11.5	10.9

Burimi: INSTAT, 2023

Sa i takon numrit të papunëve, siç mund të konkludohet nga rritja e bilancit të forcave të punës, ky numër ka rënë nga 11.5% në 10.9%, një ulje me 0.6%. Lidhur me numrin e të papunëve afatgjatë dhe atyre që përfitojnë pagesë papunësie, këto shifra kanë mbetur pothuajse të njëjta.

Tabela B.2.3.3: Nivelet e papunësisë sipas grup-moshave

	2019	2020	2021	2022
Grup-mosha 15–29 vjeç	21.5	20.9	20.9	20.7
Grup-mosha 20–40 vjeç	15.4	16.3	14.9	14.6
Grup-mosha 41–60 vjeç	8.0	8.0	8.1	7.5
Niveli zyrtar i papunësisë	11.5	11.7	11.5	10.9

Burimi: INSTAT, 2023

Përgjithësisht papunësia ka pasur një trend rënës përgjatë katër viteve të fundit, duke rënë për çdo grup-moshë me përafërsisht 1%.

Popullsia në moshë pune rritet me ritme më të larta se forca e punës dhe numri i të punësuarve, çka

përbën një sfidë për tregun e punës. Gjatë periudhës 2019–2022, forca e punës u rrit nga 1.404 mijë në 1.458.⁵ Si rregull, rritja e popullsisë në moshë pune është një “dhuratë demografike” për zhvillimin e tregut të punës, megjithatë, përvoja tregon se kjo

⁵ Tregu i punës, 2021 INSTAT.



“dhuratë” e mundshme ka gjasë të shndërrohet në një “risk demografik”, nëse nuk hapen vende të reja pune apo mungojnë mundësitë e kënaqshme të punësimit. Ndërkohë, rritja e popullsisë mbi moshën 65 vjeç përbën një barrë të shtuar mbi sistemin e mbrojtjes sociale, sidomos për skemën e pensioneve. Disa nga tiparet e tregut të punës në Shqipëri që ndikojnë në nxitjen e flukseve migratore, sipas INSTAT-it janë:

i. Meshkujt përbëjnë 55,4% të forcës së punës, ndërsa femrat 44,6%. Të punësuar vlerësohen të jenë 1.248.749 persona, ku meshkujt përbëjnë 55,5% të të punësuarve dhe femrat 44,5%. Të papunë gjithsej vlerësohen të jenë 162.560 persona, ndër të cilët 54,5% janë meshkuj dhe 45,5% janë femra. Shkalla zyrtare e papunësisë për grup-moshën 15–74 vjeç është 11,5%. Për meshkujt, shkalla e papunësisë është 0,5 pikë përqindjeje më e ulët sesa për femrat. Krahasuar me vitin 2020, punësimi është rritur me 0,4%, ndërsa shkalla zyrtare e papunësisë (për grup-moshën 15–74 vjeç) është ulur me 0,2 pikë përqindjeje, 60,9% e popullsisë 15-64 vjeç është e punësuar⁶, 8,3% është e papunë dhe 30,7% është ekonomikisht jo aktive (jashtë forcave të punës).

ii. 68,2% e meshkujve 15-64 vjeç janë të punësuar, 9,1% janë të papunë dhe 22,7% janë jashtë forcave të punës. 53,8% e femrave 15-64 vjeç janë të punësuar, 7,6% janë të papunë dhe 38,6% janë jashtë forcave të punës. Paga mesatare mujore bruto, për një të punësuar me pagë, në Shqipëri, është 57.191 lekë. Krahasuar me vitin 2020, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 6,6%. Hendeku gjinor në paga është 4,5%. Pra meshkujt kanë një pagë mesatare mujore bruto 4,5% më të lartë sesa femrat. Krahasuar me vitin 2020, vihet re një ulje e hendekut gjinor në paga me 2,0 pikë përqindjeje. 32,7% e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë

marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare.

iii. Sektori i shërbimeve dhe sektori bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 44,3% dhe 33,8% të të punësuarve gjithsej. Për vitin 2021, rezulton se 47,9% e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 32,0% janë të vetëpunësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 20,1% janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

B.2.3.2 Ndikimi i punësimit të të huajve në tregun e punës

Numri i të huajve që imigrojnë drejt Shqipërisë për motive punësimi ka ardhur në rritje, falë edhe legjislacionit shqiptar,⁷ që e ka lehtësuar punësimin e shtetasve të huaj në vend.

Situata e punësimit të të huajve, sipas sektorëve të aktiviteteve që ushtrojnë, krahasuar me vitet paraardhëse, paraqitet si më poshtë:

- Për vitin 2019 janë pajisur me leje pune 3 818 shtetas të huaj.

- Për vitin 2020 janë pajisur me leje pune 3 341 shtetas të huaj ose 12% më pak se në vitin 2019.

- Për vitin 2021 janë pajisur me leje pune 5 034 shtetas të huaj ose 51% më shumë se në vitin 2020.

- Për vitin 2022 janë pajisur me leje pune 8 305 shtetas të huaj ose 65% më shumë se një vit më parë.

Me fillimin e zbatimit të ligjit 79/2021, “Për të huajt”, janë dhënë për periudhën janar–qershor 2023 në total 4092 miratime për lejet unike, prej të cilave 3353 miratime për herë të parë. Në aspektin gjinor, 3098 janë lëshuar për meshkuj dhe 994 femra.


Duke pasur në konsideratë kategorinë e punonjësve, sipas ligjit për të huajt, pjesa më e madhe e tyre janë lëshuar për punëmarrës të thjeshtë 3499 miratime.

⁶ Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkalla e punësimit llogariten për popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomikisht aktive (ndryshe forca e punës) të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës të llogaritura mbi popullsinë 15 vjeç e lart ndikohen nga përfshirja e personave në pension në emërues dhe kështu janë më pak kuptimplotë sesa shkallët e llogaritura për popullsinë e moshës Faqe | 2596

15–64 vjeç. Ndërsa, në llogaritjen e shkallës së papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, në emërues kemi popullsinë ekonomikisht aktive, e cila përfshin personat e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune dhe të aftë për punë, dhe si rrjedhojë ky tregues nuk ndikohet nga popullsia mbi moshën e pensionit.

⁷ Ligji nr. 108/2013, datë 28.3.2013, “Për të huajt”, dhe vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 66–70 dhe 74–85, datë 12.2.2014.


Figura B.2.3.2.1 Leje unike të aprovuara



Burimi: MFE, 2023

Sa u takon lejeve unike të lëshuara në periudhën janar–qershor 2023, janë lëshuar gjithsej 4092 leje unike, 3499 nga të cilat janë lëshuar për punëmarrës (85.5%), 170 (4%) për të vetëpunësuar dhe 158 (3.8%) për vullnetarë.

Figura B.2.3.2.2 Leje unike të aprovuara sipas aktiviteteve ekonomike



Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë, 2023

Lidhur me aktivitetin ekonomik për të cilin janë lëshuar lejet, akomodimi dhe shërbimi ushqimor përbëjnë pjesën më të madhe me 14%, ndjekur nga industria përpunuese e tekstileve (11.2%) dhe industria përpunuese e produkteve ushqimore me 11.1%.

Qarku me fluksin më të madh të shtetasve të huaj të pajisur me leje dhe vërtetime pune është Tirana, me rreth 44% të lejeve të punës për vitet 2019–2022 dhe 41% për vitin 2022⁸.

⁸ AKPA, Tiranë, 2023.



Tabela B.2.3.2.1 Shpërndarja e lejeve të punës për të huajt

	2019	2020	2021	2022
ARPA Tiranë	1895	1561	2172	3409
ARPA Durrës	429	420	672	1447
ARPA Elbasan	756	551	249	1601
ARPA Vlorë	144	180	179	485
ARPA Shkodër	68	33	179	232
ARPA Fier	203	64	179	472
ARPA Lezhë	92	373	638	194
ARPA Korçë	67	24	28	29
ARPA - të e tjera	164	135	738	436

Burimi: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, 2023

Sipas të dhënave statistikore të Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, vendin e parë për periudhën 2019–2022 e zënë kërkesat për leje pune për kategorinë e punëmarrësve (2 832 në vitin 2019, 2 594 për vitin 2020, 4 357 për vitin 2021 dhe 7 434 për vitin 2022).

Në vend të dytë janë kërkesat e të vetëpunësuarve (975 në vitin 2019, 737 në vitin 2020, 672 në vitin 2021 dhe 860 në vitin 2022), ndërsa në vend të tretë janë kërkesat nga investitorët.

Nga të dhënat statistikore për vitet 2019–2022, vihet re:

- Një rritje e numrit të vërtetimeve të punës të lëshuara në aktivitete ekonomike, si: teknologjia e informacionit dhe komunikimit, industria përpunuese dhe tregtia me shumicë e pakicë. Gjithashtu, vihet re një prirje drejt rënies për vërtetimet e punës të lëshuara në sektorët e ndërtimit dhe aktiviteteve të shërbimeve të tjera.

- Një rritje e numrit të lejeve të punës të lëshuara në aktivitete ekonomike, si: tregtia me shumicë dhe pakicë, industria nxjerrëse dhe industria përpunuese. Një prirje drejt uljes së numrit të lejeve të punës për shtetasit e huaj shfaqet në sektorin e ndërtimit dhe aktiviteteve të shërbimeve të tjera.

Tabela B.2.3.2.2 Miratimet e punësimit sipas shtetësisë

	2019	2020	2021	2022
Italia	19%	9%	7%	8%
Kosova	5%	3%	3%	3%
Greqia	2%	0%	0%	0%
SHBA	3%	2%	1%	1%
Mbretëria e Bashkuar	2%	2%	1%	1%
Franca	1%	0%	1%	0%
Gjermania	2%	1%	1%	1%
Kina	6%	2%	2%	1%
Turqia	19%	20%	11%	13%
Kanadaja	2%	1%	0%	0%
Maqedonia e Veriut	1%	0%	0%	1%
India	2%	1%	3%	8%
Egjipti	6%	8%	8%	9%
Serbia	1%	0%	2%	0%
Shtetësi të tjera	31%	48%	59%	53%

Burimi: AKPA, Tiranë, 2023

Sipas shtetësisë, numrin më të lartë për lejet e punës e zënë turqit, pasuar nga italianët, pasuar nga kosovarët, pasuar nga kinezët. Të huajt e pajisur me leje dhe vërtetime pune ishin më së shumti meshkuj (83% më 2019-n, 80% më 2020-n dhe 80% më 2021-shin dhe 81% më 2022-in).

B.3. Migracioni dhe shëndetësia

Periodha kohore që mbulon ky dokument, ka paraqitur sfida të mëdha për të gjitha sistemet shëndetësore, kjo e lidhur kryesisht me pandeminë e COVID-19. Pandemia COVID-19 e vuri kujdesin shëndetësor shqiptar, siç edhe ndodhi globalisht,



përballë një prove të vështirë duke testuar çdo hallkë të tij, por nuk e dobësoi atë, përkundrazi e formëzoi më tepër duke rritur ndërveprimin ndërinstitucional nëpërmjet politikave të reja shëndetësore.

Situata e pandemisë COVID-19 u menaxhua me kujdes dhe përgjegjësi në zbatim edhe të parimeve themelore të kujdesit shëndetësor gjatë periudhës së COVID-19, në zbatim të të gjitha udhëzimeve dhe masave kufizuese të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

- COVID-19, Strategjia e Planit të Veprimit kundër COVID-19;
- COVID-19, Strategjia e Rihapjes së Sistemit të Kujdesit Shëndetësor në Shqipëri;
- COVID-19, Plani i veprimit vjeshtë-dimër 2020–2021;
- COVID-19, Plani i vaksinimit;
- COVID-19, Plani për përballimin viti 2022–2023.

Në kuadrin e nevojave për shkak të pandemisë COVID-19 u vunë në dispozicion 25 milionë euro për të forcuar sistemin shëndetësor, i cili mundësoi garantimin e mbrojtjes së stafit mjekësor me pajisje mbrojtëse personale kudo në sistemin publik.

Mësimet e nxjerra në përballjen me pandeminë si dhe orientimet globale të zhvillimit të shëndetësisë janë baza mbi të cilat u zhvillua Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030, miratuar me VKM-në nr. 210, datë 6.4.2022, e cila ka për mision mbrojtjen, përmirësimin dhe promovimin e shëndetit, rritjen e mirëqenies dhe produktivitetit të të gjithë qytetarëve në Shqipëri, garantimin e ofrimit të kujdesit shëndetësor cilësor në kohë dhe të përbalueshëm për popullatën shqiptare, sigurimin e progresit të qëndrueshëm në shëndetin publik dhe kujdesin shëndetësor si dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit shëndetësor për emergjencat dhe shfrytëzimin e inovacioneve dhe integritit të kujdesit për fuqizimin e sistemit shëndetësor.

Ndërhyrjet e planifikuara dhe të zbatuara në sistemin e shëndetësisë gjatë viteve kanë synuar, ndër të tjera, edhe shkurajimin e flukseve migratore për motive shëndetësore, duke rritur qasjen e popullatës në shërbimet e kujdesit shëndetësor nëpërmjet masave për mbulimin shëndetësor universal; stimujve të vazhdueshëm për personelin mjekësor tashmë të formuar, si dhe ndryshimit të kuadrit rregullator për personelin e ardhshëm

mjekësor, me qëllim sigurimin e mbulimit më të mirë shëndetësor të popullsisë, përmirësimin rrënjësor të infrastrukturës së institucioneve shëndetësore dhe pajisjeve dhe aparatave për ekzaminim dhe trajtim mjekësor, uljes së çmimeve dhe rritjes së cilësisë së barnave; harmonizimit të politikave shëndetësore me politikat sociale, të punësimit, arsimore etj.

Sistemi shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik. Shteti siguron shumicën e shërbimeve të ofruara për popullsinë në fushën e promovimit, parandalimit, diagnostikimit dhe trajtimit. Sektori privat mbulon shumicën e shërbimit farmaceutik dhe atij dentar, si dhe disa shërbime të specializuara diagnostikuese dhe trajtuese. Shërbimi diagnostikues dhe kurativ shëndetësor është i organizuar në tri nivele: shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor, dytësor nën koordinimin e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe terciar. Shërbimi shëndetësor publik dhe ndërgjegjësimi ofrohen në kuadër të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor dhe mbështeten e mbikëqyren nga Instituti i Shëndetit Publik përmes zyrave vendore të kujdesit shëndetësor. Skema e sigurimeve shëndetësore, e cila vepron në bazë të parimit të solidaritetit dhe barazisë administrohet nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, me synim që të sigurojë fleksibilitet në financimin e shërbimeve shëndetësore, transparencë në administrim dhe besueshmëri maksimale të popullatës, në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor.

Modeli i skemës së sigurimeve shëndetësore në Republikën e Shqipërisë është i përzier dhe bazohet në kontributet shëndetësore të detyrueshme dhe ato vullnetare, si dhe në financimin nga buxheti i shtetit.

Gjatë periudhës 2020–2022 është ofruar shërbim shëndetësor në shërbimin spitalor publik për të huajt në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi, kryesisht të lidhura me kufizimet në kuadër të Pandeminë e COVID-19 si dhe angazhimeve të Shtetit Shqiptar në ofrimin e shërbimeve për të huajt nën mbrojtje ndërkombëtare, siç pasqyrohen në tabelën e mëposhtme. Nga të dhënat e raportuara nga shërbimet spitalore, përveç QSUT-së, si shërbimi më i specializuar në nivel kombëtar, dhe shërbimeve të tjera spitalore terciare, më shumë persona të huaj janë trajtuar në shërbimin spitalor Lezhë, ndjekur nga Dibra, Vlora dhe Devolli.



Tabela B.3.1 Pacientë të huaj që kanë marrë shërbim spitalor në vend

Vitet	2020	2021	2022
Total	939	2491	2166

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (FSDKSH) Tiranë, 2023

Ndikimet kryesore të migracionit në sistemin shëndetësor konstatohen në aspektet e mëposhtme:

B.3.1 Ndikimi i emigracionit të specialistëve të shëndetësisë dhe sfidat e sistemit shëndetësor

Pas viteve '90 forcat e punës, ndër to edhe ato të sektorit të shëndetësisë, u prekën nga lëvizjet migratore, kryesisht jashtë vendit. Megjithëse Shqipëria, vitet e fundit është prekur nga largimi i stafëve mjekësore të formuara, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një sërë masash rregullatore dhe incentivash për sigurimin e mbulimit me shërbime shëndetësore në nivel kombëtar.

Në vitin 2019⁹ kishim 16.6 mjekë për 10,000 banorë, ndërkohë në vitin 2022 ky koeficient është 19.3 mjekë për 10,000 banorë.

Në lidhje me numrin e infermierëve në vitin 2019 kishim gjithsej 47.6 infermierë për 10,000 banorë, ndërkohë në 2022 ky koeficient është 56.4 infermierë për 10,000 banorë.

B.3.2 Ndikimi i migrimit të brendshëm në konfigurimin e rrjetit të ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor

Migrimi i brendshëm i popullsisë kryesisht prej zonave rurale drejt zonave urbane ka ndikuar pashmangshmërisht edhe në ndryshimin e raporteve të mjekëve dhe infermierëve me popullsinë e këtyre zonave.

Nga të dhënat e mbulimit shëndetësor, në këto katër vjet në shërbimin parësor vërehet rënie e numrit të mjekëve të familjes. Rënia më e theksuar është në grupimin e mjekëve të zonave rurale, edhe për shkak të prirjes së njëjtë që shfaq edhe popullata e mjekëve për të lëvizur drejt zonave urbane. Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja e mjekëve dhe infermierëve të kujdesit shëndetësor parësor në territorin e vendit, sipas zonave urbane dhe rurale.

Tabela B.3.2 Shpërndarja e stafëve mjekësore në shërbimin parësor sipas zonave urbane dhe rurale

	2019	2020	2021	2022
Zona urbane				
Mjekë	813	826	839	814
Infermierë	2905	2903	2815	3693
Zona rurale				
Mjekë	667	663	666	637
Infermierë	4053	3960	4027	3099

Burimi: (FSDKSH) Tiranë, 2023

Tashmë prej disa vitesh politikat shëndetësore lidhur me rekrutimin e personelit për të plotësuar nevojat e popullsisë për kujdes shëndetësor janë përmirësuar dukshëm në terma të transparencës dhe meritokracisë. Sot, punësimi i personelit në shërbimet e sistemit shëndetësor kryhet përmes portaleve, çka siguron jo vetëm transparencën e procesit, por edhe mundësi më të mëdha përmes informacionit të plotë që marrin mjekët dhe infermierët për vendet e lira në sistem, sipas nevojave të identifikuara nga vetë shërbimet shëndetësore.

B.3.3 Rritja e rrezikut të sëmundshmërisë

Ndryshimet ekonomike, sociale e demografike që kanë ndodhur gjatë 25 vjetëve të fundit e kanë rritur shkallën e rrezikut për importimin dhe përhapjen e sëmundjeve që nuk i hasnim më parë. Rritja e numrit të udhëtimeve jashtë dhe brenda vendit përbëjnë rrezik potencial për importimin dhe përhapjen e tyre. Emigrimi ka sjellë ndryshime në mënyrën e jetesës, duke shtuar rreziqe të reja për shëndetin.

⁹ Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (FSDKSH) Tiranë, 2023.

B.3.4 Ndikimi i të kthyerve nga emigracioni në nevojën për mbulim me vakcina në Shqipëri

Vaksinimi është një e drejtë themelore e fëmijëve dhe institucionet e kujdesit shëndetësor kanë detyrim të krijojnë kushtet që ky shërbim të ofrohet kudo dhe të jetë i sigurt, pavarësisht vendbanimit dhe kushteve të tyre social-ekonomike. Vaksinimi i përgjithshëm kundër sëmundjeve që parandalohen me anë të tij është vendimtar për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe të fëmijëve.

Imunizimi i fëmijëve me vakcinat bazë është një nga ndërhyrjet shëndetësore me efikasitetin më të lartë. Shqipëria ka një program kombëtar vaksinimi të konsoliduar. Në vendin tonë, mbulimi për çdo vaksinë të kalendarit kombëtar aktualisht është mbi 94%. Gjatë viteve 2019–2022 ka pasur kthim të fëmijëve emigrantë dhe ata janë përfshirë në kalendarin kombëtar të vaksinimit, duke marrë parasysh vaksinimet e dokumentuara të kryera në vendin ku kanë qëndruar më parë dhe vazhdimin e kalendarit aty ku është ndërprerë. E njëjta qasje është zbatuar edhe për kategorinë e të huajve nën mbrojtje ndërkombëtare.

Tabela B.3.4.1 Mbulimi për çdo vaksinë të kalendarit kombëtar/vaksinimi

Viti	Tuberkulozi BCG (në lindje)	Hepatiti Viral B (në lindje)	Penta (doza e parë)	Penta (doza e dytë)	Penta (doza e tretë)	Pneumo (doza e parë)	Pneumo (doza e dytë)	Pneumo (doza e tretë)	Difteri, Tetanoz, Pertusksinim I	Fruth Rubeole Parotit (doza I)	Fruth-Rubeole-Parotit (doza II)	Difteri, Tetanoz (rivaksinimi II)	Difteri, Tetanoz (rivaksinimi III)	Difteri, Tetanoz (rivaksinimi IV)	Poliomieliti (doza I)	Poliomieliti (doza II)	Poliomieliti (doza III)	Poliomieliti (rivaksinimi I)	Poliomieliti (rivaksinimi II)
2019	98.9	99.3	98.8	98.8	98.6	98.8	98.8	95.6	97.2	95.0	96.2	96.9	95.7	93.3	98.8	98.8	98.6	96.6	96.9
2020	98.8	99.3	98.7	98.4	98.5	98.5	98.4	92.4	95.1	91.0	94.1	95.9	92.3	89.6	98.6	98.4	98.3	95.1	95.9
2021	98.8	99.3	98.1	97.7	97.5	98.2	97.6	89.1	92.5	86.6	91.7	93.4	90.3	89.1	98.1	97.7	97.6	92.5	93.3
2022	98.7	99.1	98.3	98.0	97.5	98.3	98.0	87.5	91.9	85.7	92.8	93.0	89.1	86.5	98.3	98.0	97.4	92.0	91.9

Burimi: MSHMS/ISHIP, 2023

B.3.5 Nevoja për vaksinimin e personave që lëvizin në drejtim të vendeve me rrezikshmëri për sëmundje infektive

Ndryshimet sociale, ekonomike dhe demografike që kanë ndodhur gjatë këtyre 20 viteve të fundit, rritja e numrit të udhëtimeve dhe shkalla ende e lartë e lëvizjeve migratore përbëjnë rrezik për importimin e sëmundjeve që i kishim eliminuar më parë dhe ato të shfaqura rishtash. Çdo udhëtar që udhëton në vende me rrezik për sëmundje infektive i nënshtrohet vaksinimit në Klinikën e Sëmundjeve Infektive në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë (QSUT), pavarësisht nga koha e qëndrimit në atë vend. Kjo klinikë, ashtu sikurse edhe Instituti i Shëndetit Publik, ofron këshillim për udhëtarët, sipas vendeve përkatëse ku do të udhëtojnë.

Gjithashtu, periudha të cilën mbulon ky dokument, përkon edhe me Pandeminë e COVID-19. Nga fillimi i procesit të vaksinimit kundër COVID-19, me datë 11 janar të vitit 2021 deri në fund të vitit 2022 (duke përfshirë vaksinimet jashtë vendit) mbulesa vakcinale në popullatën e përgjithshme është si më poshtë (popullata e përgjithshme sipas INSTAT-it është 2 829 741 banorë).



Tabela B.3.5.1 Mbulesa vaksinale kundër COVID-19

Mbulesa vaksinale në popullatën e përgjithshme sipas dozave	11.01.2021–31.12.2022
Me një dozë	49%
Me dy doza	45.8%
Me tri doza	13.5%
Me katër doza	1.5%

Burimi: MSHMS, 2023

B.3.6 Rritja e rrezikut të infektimit me HIV/AIDS

Të dhënat ekzistuese dëshmojnë se në Shqipëri nuk ka epidemi të gjeneralizuar apo të përqendruar të infeksionit HIV. Ndërsa numri vjetor i rasteve të raportuara mbeti nën 50 raste deri në vitin 2010, midis vitit 2010 dhe 2022 numri vjetor i rasteve të raportuara me HIV u rrit më shumë se 2 herë nga 48 raste (2008) në 127 raste (4.5 raste/100.000 që ishte niveli më i lartë) më 2016-n.

Numri i rasteve të reja të diagnostikuara në vitin 2022 është 98, ndërsa referuar të dhënave kumulative, gjatë periudhës 1993–2022, numri total i rasteve të raportuara me HIV/AIDS është 1604. Në fund të 2022-shit, prevalenca e infeksionit vlerësohet të jetë me 0,06%, ndërsa incidenca (rastet e reja në 2022) 3.5 për 100,000 banorë.

Tabela B.3.6.1 Prevalenca e HIV-AIDS/Rreziku i infektimit me HIV-AIDS

	2019	2020	2021	2022
Prevalenca	0.46%	0.05%	0.05%	0.06%
Incidenca	3.5/100000 banorë ose (0.0035%)	3.3/100000 banorë ose (0.0034%)	3.6/100000 banorë ose (0.0037%)	3.5/100000 banorë ose (0.0035%)
Numri i përgjithshëm i raportuar (kumulativ që prej vitit 1993)	1306	1402	1506	1604
Numri i rasteve të reja në vit	101	96	104	98

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/ ISHP

Ndonëse prevalenca e infeksionit HIV është e ulët, vitet e fundit vihet re se ka prirje për rritjen e numrit të rasteve, krahasuar me vendet e rajonit. Sa i përket vendit të marrjes së infeksionit HIV, numri më i madh i rasteve në katër vitet e fundit (92%–98%) raportohet ta kanë marrë virusin brenda vendit.

Tabela B.3.6.3 Vendi i marrjes së infeksionit HIV-AIDS (në%) për rastet e reja, bazuar në vendin e konfirmimit të diagnozës

	2019	2020	2021	2022
Shqipëri	92% (93 raste)	96% (92 raste)	97% (101 raste)	98% (96 raste)

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/ ISHP

C. KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR MENAXHIMIN E MIGRACIONIT, PËR PERIUDHËN 2019–2022

C.1. Kuadri politik për menaxhimin e migracionit

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane, Shteteve Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të saj, përmban detyrime për vendin tonë në fushën e lëvizjes së lirë për punëtorët.

Dokumenti kryesor strategjik që përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit dhe përcakton vizionin dhe qëllimet strategjike për politikën e migracionit në të ardhmen është **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030**. Politikën në fushën e migracionit shihen të lidhura ngushtë me proceset globale të migracionit dhe integrimin e Shqipërisë në BE. Qëllimi strategjik për migracionin deri në vitin 2030 është: “Qeverisja e efektshme e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të



problematikave dhe sfidave që lindin nga lëvizjet migratore, duke synuar rritjen e ndikimit të migracionit të zhvillimi, në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë shqiptare”.¹⁰

Detyrimet e lidhura me procesin e integritimit evropian dhe veçanërisht ato nën kapitujt 2, 24, 3 dhe 19 shihen si pjesë të rëndësishme për menaxhimin e migracionit në të ardhmen. Dy synimet e politikave që vlerësohen të prioritetet në këtë strategji janë: 1. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit të zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal; dhe 2. Promovimi i migracionit të rregullt dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare.

Gjatë periudhës 2019–2022, politikat dhe ndërhyrjet kryesore në fushën e migracionit janë përcaktuar në **Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2019–2022**. Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019–2022 ishte: “Qeverisje efektive e migracionit në Shqipëri për të adresuar sfidat që rezultojnë nga lëvizjet migratore dhe për të rritur ndikimin e migracionit në zhvillimin e vendit në përfitim të migrantëve dhe shoqërisë”. Hartimi i kësaj strategjie ishte një nga rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2018. Ndërkohë, ndërhyrjet për migracionin për motive punësimi janë reflektuar dhe në Strategjinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2019–2022. Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2019–2022, ishte: “Aftësi më të larta dhe vende pune më të mira për të gjithë, gratë dhe burrat”.

Gjatë vitit 2022 me përfundimin e SKPA 2019–2022, u punua për **hartimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030**. Në tekstin e saj ajo shpreh përputhshmërinë me vizionin dhe objektivat e SKZHI 2030 dhe për pasojë pjesë e rëndësishme e saj është dhe integrimi evropian. Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2030 është: “Punësim cilësor dhe aftësim gjatë të gjithë jetës për të gjithë”¹¹. Për herë të parë në këtë strategji krahasuar me strategjitë e mëparshme të punësimit, ka një fokus të veçantë

për shtetasit shqiptarë që kthehen në vend pas emigrimit dhe për të huajt, imigrimin e punës dhe punëtorët imigrantë. Strategjia e mëparshme kombëtare e punësimit nuk e trajtonte këtë kategori punonjësisht në mënyrë të veçantë.

Në përfundim të Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2019–2022, me urdhër të Kryeministrit¹² është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të saj të Veprimit 2024–2030.

Në fokus për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planit të veprimit zhvillimin dhe zbatimin e një politike të qeverisjes së migracionit të harmonizuar me Paktin Global për Migracionin (GCM), Strategjinë e Bashkimit Evropian për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin, si dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI).

Për më tepër, bazuar në potencialet e diasporës dhe të dobisë së angazhimit të saj në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe shoqëror të vendit, Shqipëria ka miratuar dy strategji kombëtare për diasporën shqiptare, e para për vitet 2018–2024 dhe Strategjia Kombëtare për Diasporën Shqiptare 2021–2025 që është vazhdim i aplikimit Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018–2024.

Mbi bazën e kësaj të fundit, u miratua një legjislacion i ri dhe një politikë të re shtetërore për marrëdhëniet me diasporën¹³. Objektivi i **Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021–2025** është që të prodhojë një kuadër të plotë për angazhimin e diasporës, në përputhje me udhëzuesin e BE-së për politikën dhe me standardet ndërkombëtare. Strategjia synon të krijojë mekanizma, të cilët do të mbështesin komunitetet shqiptare në diasporë, si edhe angazhimin bashkëpunues të institucioneve shtetërore.

Politikat për menaxhimin e integruar të kufirit nëpërmjet bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar të të gjitha autoriteteve dhe agjencive, me fushë përgjegjësie sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë dhe lëvizjes janë përcaktuar në **Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të**

¹⁰ Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, 2022, f. 41.

¹¹ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2023, f. 31.

¹² Urdhërin e Kryeministrit nr. 9, datë 26.1.2023.

¹³ Strategjia Kombëtare e Diasporës, 2021–2025 dhe planin e veprimit, me vendimin nr. 585, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave.



Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe Plani i Veprimit 2021–2023.

Vizioni i kësaj strategjie është: “Sigurimi i një qarkullimi të qetë e të sigurt të shtetasve dhe mallrave nëpërmjet kufirit shtetëror dhe marrja e masave të nevojshme për të parandaluar dhe për të goditur të gjitha format e krimit ndërkufitar dhe të migrimit të parregullt”.

Hartimi dhe zbatimi i politikave migratore ka pasur synim progresin në menaxhimin me efektivitet të migracionit në Shqipëri, duke iu përgjigjur disa sfida mbeten ende aktuale, si:

Parandalimi i plotë i fenomenit të emigrimit të parregullt të shtetasve shqiptarë dhe keqpërdorimi i regjimit pa viza, në zonën *Schengen* dhe BE; trajtimi efektiv i flukseve të përziera migratore që vijnë nga zonat e konfliktit; forcimi i mekanizmit të riintegrimit, me qëllim garantimin e një kthimi të qëndrueshëm të shtetasve shqiptarë, përmes ofrimit të mbështetjes; ndikimi i zhvillimit të migrimit, duke minimizuar kostot e migracionit të parregullt dhe duke maksimizuar përfitimet nga migracioni i rregullt; promovimit të investimeve njerëzore dhe financiare të shqiptarëve që janë jashtë vendit për vendin; forcimi i strukturave të menaxhimit të migracionit dhe politikave të imigracionit në drejtim të integritetit të imigrantëve, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Dokumentet e politikave të sipërpërmendura nuk janë shteruese për fushën e migracionit. Që prej vitit 2019 janë zbatuar disa dokumente strategjike të politikave për migracionin, si Planin e Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2021–2023); Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (2019–2022); Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë (2021–2030), Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin (2021–2027); Strategjinë për Biznesin dhe Investimet (2021–2027); Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Plani i Veprimit.

C.2 Kuadri ligjor për migracionin

Kuadri ligjor për migracionin është pjesërisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së. Aktualisht është duke u punuar për hartimin Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planin e veprimit.

Vlen të theksohet se gjatë 2019–2022 ka pasur zhvillime të rëndësishme të legjislacionit për sa i përket fushës së migracionit. Konkretisht është miratuar ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”, që përaftron 15 direktiva dhe vendime të *acquis* komunitare, ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSHP”, i cili përaftron 5 direktiva si dhe ligji nr. 113/2020, “Për shtetësinë”.

C.2.1 Legjislacioni i brendshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton drejtpërdrejt çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e të huajve në Republikën e Shqipërisë, si: liria e lëvizjes, mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë e me dinjitet i të huajve, mbrojtja e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, ndalimi i dëbimeve kolektive të shtetasve të huaj, e drejta e proceseve të ankimeve gjyqësore etj.¹⁴, duke plotësuar kështu kriteret e parashikuara në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që trajtojnë çështje migratore, që janë ratifikuar nga vendi ynë, si:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e vitit 1948;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile Politike e vitit 1966;
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, që hyri në fuqi më 4 janar 1969;
- Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, 3 shtator 1953, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 2.3.2005;
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, miratuar më 18 dhjetor 1990;
- Konventa nr. 97 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Migracionin për Punësim (e rishikuar) në 1949-n, hyrë në fuqi më 22 janar 1952;
- Konventa 143, “Për punonjësit migrantë” (dispozita plotësuese), 1975;
- Konventa 181 e ILO-s, “Për agjencitë private të punësimit”;
- Konventa e Këshillit të Evropës, “Statusi ligjor i punëtorëve migrantë”.

¹⁴ Miratuar me ligjin nr. 84, datë 21.10.1998, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 28, datë 7.12.1998, faqe 1073, pika 1, neni 16, kreu I, pjesa e dytë; neni 19, kreu I, pjesa e dytë; germa “dh”, pika 2, neni 27, kreu I, pjesa e dytë; neni 38, Faqe | 2604

kreu I, pjesa e dytë, neni 39, kreu I, pjesa e dytë, neni 40, kreu I, pjesa e dytë, si dhe dispozita “kushdo” që gjenden në përmbajtjen e saj.



Shqipëria ka një shkallë shumë të lartë të ratifikimit të konventave ndërkombëtare në fushën e migracionit, edhe pse statusi i zbatimit të tyre dhe ndikimi në të drejtat e migrantëve mbetet i panjohur.

Kuadri ligjor shqiptar gjatë viteve të fundit ka qenë në një përputhje me legjislacionin e BE-së dhe ka synuar të ndërtojë një politikë migratore sa më të fortë dhe koherente. Aktet normative në zbatim të tij janë përmirësuar jo vetëm në aspektin e procedurave të dokumenteve të udhëtimit, vizave, punësimit, qëndrimit, bashkimit familjar, por edhe në drejtimit të mbrojtjes së të drejtave të të gjithë migrantëve dhe familjeve të tyre. Në periudhën 2019–2022 janë hartuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, që kanë pasur për qëllim përmirësimin e përgjigjes ndaj sfidave migratore.

Legjislacioni kombëtar për migracionin përbëhet nga aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”, shënon një përmirësim të mëtejshëm të normativës migratore për të huajt, duke e harmonizuar atë pjesërisht me legjislacionin e BE-së në këtë fushë, për aq sa i kërkohej Shqipërisë në pozicionin e saj aktual, por dhe duke pasur parasysh perspektivën e afërt në proceset integruese, i cili ka si qëllim rregullimin e regjimit të hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë. Disa nga risitë kryesore që trajtoi ky ligj janë:

- Leja e unike: një procedurë e vetme aplikimi për të huajt që duan të punojnë në Republikën e Shqipërisë, po ashtu dhe lëshimi i një dokumenti i vetëm qëndrimi, ku është i integruar dhe miratimi i punësimit.

- Riformulimi i dispozitave që kanë të bëjnë me lëshimin e lejes së qëndrimit për raste humanitare, duke lënë mundësinë të shtohen edhe kategori të reja në përputhje me zhvillimet e së drejtës ndërkombëtare, sidomos asaj evropiane.

- Rishikimi i kategorive të të huajve që pajisen me leje qëndrimi, duke shtuar kështu edhe kategoritë e reja në përputhje me standardet e *aquis communitaire*, garanton ligji i ri edhe të drejtën për studentët dhe kërkuesit shkencorë që të qëndrojnë të paktën 9 muaj mbas mbarimit të afatit të studimeve, apo kërkimeve, në mënyrë që të kenë mundësi të aplikojnë për punë, apo për të krijuar një biznes në Republikën e Shqipërisë.

- Vëmendje të shtuar ligji i kushton, gjithashtu, edhe bashkimeve familjare, si edhe të drejtave që

kanë anëtarët e familjes së atyre që kanë një leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, për t'u bashkuar me familjarët e tyre, gjithmonë sipas standardeve të BE-së në këtë fushë.

- Përmirësimi i dispozitave që kanë të bëjnë me të drejtat e të ndaluarve në qendrat e mbyllura në Republikën e Shqipërisë në kthimet e tyre.

- Risi sociale është ajo që ka të bëjë me zbatimin në praktikë të dispozitave të Konventës për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në komunitet.

Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Direktivën 2011/98/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2011, “Mbi një procedurë të vetme aplikimi për një leje të vetme për shtetasit e vendeve të treta për të qëndruar dhe punuar në territorin e një shteti anëtar dhe për një grup të përbashkët të të drejtave për punëtorët e vendeve të treta me qëndrim të ligjshëm në një shtet anëtar”.

- Direktivën (BE) 2016/801 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 maj 2016, “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime kërkimi, studimesh, trajnimesh, shërbimi vullnetar, skemash të shkëmbimit të nxënësve ose projekteve arsimore dhe *au pairing*”.

- Direktivën e Këshillit 2003/110/KE, datë 25 nëntor 2003, “Për ndihmën në rastet e tranzitit për qëllimet e largimit në rrugë ajrore”.

- Vendimin e Këshillit 2004/573/KE, datë 29 prill 2004, “Mbi organizimin e fluturimeve të përbashkëta për largime nga territori i dy ose më shumë shteteve anëtare, të shtetasve të vendeve të treta që janë objekt i urdhrave individualë të largimit”.

- Direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta, me qëllim të punësimit si punëtorë sezonalë”.

- Direktivën 2014/66/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta, në kuadrin e një transferimi brenda korporatës”.

- Direktivën 2009/52/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 18 qershor 2009, “Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe të masave ndaj punëdhënësve të



shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme”.

- Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim pune shumë të kualifikuar”.

- Direktivën 2008/115/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, “Mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në shtetet anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt”.

- Direktivën e Këshillit 2004/82/KE, datë 29 prill 2004, “Mbi detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët”.

- Direktivën e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004, “Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara për shtetasit e vendeve të treta, që janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për të lehtësuar imigracionin e paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente”.

- Direktivën e Këshillit 2003/109/KE, datë 25 nëntor 2003, në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë, e ndryshuar.

- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003, “Mbi të drejtën e bashkimit familjar”.

- Direktivën e Këshillit 2000/78/KE, datë 27 nëntor 2000, “Për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion”.

- Direktivën 96/71/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 1996, në lidhje me transferimin e punëtorëve, në kuadër të ofrimit të shërbimeve, e ndryshuar.

- Direktivën 2004/38/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2004, “Mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare, që ndryshon rregulloren (KEE) nr. 1612/68 dhe që shfuqizon direktivat 64/221/KEE, 68/360/KEE, 72/194/KEE, 73/148/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE dhe 93/96/KEE”, e ndryshuar”.

- Rregulloren (KE) nr. 810/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Për krijimin e Kodit të Komunitetit për Vizat (Kodi i Vizave)”, e ndryshuar.

- Vendimin kuadër të Këshillit, 2002/946/DÇB, datë 28 nëntor 2002, “Mbi forcimin e kuadrit penal për të parandaluar ndihmën e hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar”.

- Sidoqoftë, vlen të theksohet se përafrimi i legjislacionit të migracionit me *Acquis* të BE-së dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria vazhdon.

- Në zbatim të ligjit nr. 79/2021 janë miratuar edhe 25 akte nënligjore, vendime të Këshillit të ministrave, udhëzime dhe urdhra.

Disa nga aktet me të rëndësishme në zbatim të ligjit janë:

- Vendimi nr. 858, datë 29.12.2021, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Vendimi nr. 857, datë 29.12.2021, “Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar për të huajt në Republikën e Shqipërisë”.

- Vendimi nr. 450, datë 29.6.2022, “Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejeve të qëndrimit për të huajt”.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 22.2.2023, “Për miratimin e formatit të aktit administrativ që vendos masën administrative dhe llojit të masave që përbëjnë, shkak për kufizimin e hyrjes”, shoqëruar nga relacioni shpjegues.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 17.2023, “Për miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi, të dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit, të dokumentit të përkohshëm, publikatës së lejes së qëndrimit e të lejes unike, si dhe të letërnjoftimit për të huajt”.

- Urdhri nr. 178, datë 22.6.2022, i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit Vlerësues për plotësimin e kushteve të lejes unike si investitor”.

- Urdhri nr. 180, datë 22.6.2022, i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit Vlerësues për plotësimin e kushteve të lejes unike si i vetëpunësuar”.

- Udhëzimi nr. 19, datë 22.6.2022, i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për deklarimin për punësim”.

- Udhëzimi nr. 18, datë 22.6.2022, i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për miratimin e



procedurave të bashkëpunimit ndërinstitucional për përcaktimin e kuotave vjetore për punësim”.

- Udhëzim i përbashkët nr. 3, datë 11.1.2023, i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse të Ministrisë së Brendshme dhe autoriteteve përgjegjëse të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për përcaktimin e procedurave për miratimin e lejes unike”.

- Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 240, datë 16.12.2022, për përcaktimin e vlerës së investimit për pajisjen me leje unike për investitor”.

Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, parashikon kushtet dhe procedurat për dhënien dhe heqjen e azilit, mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtjes së përkohshme në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve e të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese, të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

Për të siguruar zbatueshmërinë e ligjin janë miratuar edhe 15 aktet nënligjore, si më poshtë:

- VKM-ja nr. 630, datë 27.10.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Pritjes së Azilit”.

- VKM-ja nr. 201, datë 6.4.2022, “Për kushtet, kriteret dhe afatet për përcaktimin e procedurave të përshpejtuara për qëndrimin e kërkuar për mbrojtjen ndërkombëtare”.

- VKM-ja nr. 855, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kushteve minimale të jetesës dhe kushteve sociale për aplikantët për mbrojtje ndërkombëtare”.

- VKM-ja nr. 669, datë 10.11.2021, “Për kriteret e emërimit, arsyet e lirimit ose të shkarkimit, si dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët”.

- VKM-ja nr. 601, datë 14.9.2022, “Për miratimin e listës së vendeve të treta si vende të treta të sigurta”.

- Urdhri nr. 250, date 3.6.2021, i ministrit të Brendshëm, “Për përmbajtjen dhe mënyrën e administrimit të regjistrimit elektronik të azilkërkuesve dhe personave nën mbrojtje ndërkombëtare”.

- Urdhri nr. 249, datë 3.6.2021, i ministrit të Brendshëm, “Për miratimin e formularit të aplikimit për bashkim familjar në Republikën e Shqipërisë”.

- Urdhri nr. 248, datë 3.6.2021, i ministrit të Brendshëm, “Për miratimin e formatit të vërtetimit mbi dorëzimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- Urdhri nr. 247, datë 3.6.2021, i ministrit të Brendshëm, “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave të dërgimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët”.

- Urdhri nr. 244, datë 3.6.2021, i ministrit të Brendshëm, “Për miratimin e formatit të vërtetimit të mosshqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- Udhëzimi nr. 269, datë 1.7.2021, i ministrit të Brendshëm, “Për përcaktimin e procedurës së Regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, të refugjatit, ose të personit, në mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë”.

- Udhëzimi nr. 246, datë 3.6.2021, i ministrit të Brendshëm, “Për procedurën dhe afatin për marrjen e vendimit të pushimit të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- Udhëzimi nr. 245, datë 3.6.2021, i ministrit të Brendshëm, “Për rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave e të deklarimeve nga vendi origjinës për azilkërkuesin dhe refugjatit”.

- Udhëzim i përbashkët me ministrin e Drejtësisë nr. 39, datë 16.3.2022, “Për dhënien e ndihmës juridike të garantuar nga shteti për aplikantët për mbrojtje ndërkombëtare”.

- Udhëzimi nr. 72, datë 18.5.2022, i ministrit të Brendshëm, “Për procedurat e pajisjes me karta identiteti elektronike dhe dokumente udhëtimi të shtetasve që kanë përfutur statusin e refugjatit dhe mbrojtje suplementare në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar, rregullon marrëdhëniet në fushën e emigracionit për qëllime punësimi ose formimi profesional nëpërmjet punës të shtetasve shqiptarë që largohen nga Republika e Shqipërisë. Zbatimi i këtij ligji mbetet problematik, çka shtrton nevojën për një kuadër të ri që rregullon emigrimin dhe kthimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi.



Përveç akteve ligjore të sipërcituara, pjesë e kuadrit normativ migrator janë edhe:

Ligji nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm”, ligji konsullor dhe legjislacioni i brendshëm që rregullon shërbimet konsullore, vendos bazat normative për funksionimin e shërbimit konsullor dhe shërbimeve bazë që u ofrohen shtetasve.

Ligji nr. 92/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 16/2018, ‘Për diasporën’”.

Ligji nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Ligji nr. 32/2018, “Për krijimin e fondit shqiptar për zhvillimin e diasporës”.

Vendimi nr. 469, i Këshillit të Ministrave, “Për Qendrën e Botimeve për Diasporën”.

Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat kanë për qëllim përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Akte të miratuara kundër trafikimit të personave:

U miratua **Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave, 2021–2023**¹⁵. Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave shpreh angazhimin e shtetit dhe qeverisë shqiptare, të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, të aktorëve antitrafik, që punojnë në strukturat publike dhe jopublike, për minimizimin e dukurisë së trafikimit të personave. Aktivitetet e parashikuara në PKV, 2018–2020, kanë si synim të përmirësojnë funksionimin e një sistemi gjithëpërfshirës nëpërmjet forcimit të mekanizmit të identifikimit, mbrojtjes dhe riintegritimit të viktimave të trafikimit.

Në kuadër të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, MSHMS-ja ka hartuar dhe po monitoron një sërë dokumentesh strategjike dhe ligjore, me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e mbrojtjes, kujdesit dhe integritetit të individëve dhe grupeve në nevojë, me fokus të veçantë fëmijët, gratë viktime të dhunës dhe

të trafikuar, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin rom dhe egjiptian etj., të cilët mund të jenë më vulnerabël karshi fenomenit të migracionit.

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit¹⁶ PSV-të janë dokumenti bazë për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Qëllimi i miratimit të PSV-ve është mbrojtja, përfshi identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur, shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, ndaj të gjitha llojeve të shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, që janë të lidhura ose jo me krimin e organizuar.

Ligji nr. 15/2019,¹⁷ “Për nxitjen e punësimit”, i cili ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimit profesional. Nga ky ligj përfitojnë të gjithë shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, ata me statusin e refugjatit, si dhe azilkërkuesit, të cilët hyjnë e qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime punësimi. Ky ligj ofron mundësinë e pajisjes me leje pune, në zbatim të legjislacionit në fuqi për të huajt

Ligji nr. 15/2017,¹⁸ “Për arsimin dhe formimin profesional”, i cili parashikon njohjen dhe certifikimin e kualifikimeve profesionale, sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK); Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale; listën kombëtare të profesioneve; njohjen e kompetencave të përfuara nga diku tjetër, si dhe këshillimin dhe orientimin e karrierës.

Ligji nr. 69/2012,¹⁹ “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky ligj parashikon të drejtën për t’u arsimuar të të huajve dhe personave pa shtetësi; Arsimimi në dy gjuhë sipas marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të

¹⁵ VKM-ja nr. 670, datë 10.11.2021, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave, 2021–2023”.

¹⁶ VKM-ja nr. 499, datë 29.8.2018, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

¹⁷ Ligj për nxitjen e punësimit – ISHPSSH: <https://inspektoriatipunes.gov.al/ep->

<content/uploads/2021/05/6-Ligji-15-dt.-13.3.2019-PER-NXITJEN-E-PUNESIMIT-.pdf>

¹⁸ Ligj nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” Qendra e Botimeve Zyrtare QBZ (n.d.). <ligj-2017-02-16-15-2017.pdf>

¹⁹ Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i azhurnuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.



tjera; sigurimin e mbështetjes profesionale dhe bashkëpunimin me organizma dhe shtete të huaja.

Ligji nr. 22/2018,²⁰ “Për strehimin social”, nga i cili përfitojnë dhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”.

Ligj nr. 14/2016,²¹ Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë, i cili ka si qëllim identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe VKM-në përkatëse.

C.2.2 Bashkëpunimi dypalësh

Përveç përmirësimit të kuadrit të brendshëm normativ, gjatë viteve 2019–2022 legjislacioni shqiptar mbi migracionin është pasuruar me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me vende fqinje dhe të BE-së:

Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Departamentit të Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, forcës së kufirit lidhur me bashkëpunimin e ndërsjellë, zhvillimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive sa u përket të gjitha çështjeve të kufirit shqiptar.

Marrëveshja dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, ratifikuar nga Parlamenti me ligjin 14/2018, datë 29.3.2018, hyrë në fuqi më 1.12.2018.

Marrëveshja për sigurimet shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, ratifikuar më 28.3.2022, dhe hyrë në fuqi në 1.7.2022.

Marrëveshja për sigurimet shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë, ratifikuar me ligjin nr. 58/2019, dhe hyrë në fuqi më 1.8.2022.

Protokoll për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës për Bashkëpunim Policor të Evropës Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së,

daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve, të ratifikuar me ligjin 13/2019.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut mbi Ripranimin e Personave dhe Protokollit Zbatues të Marrëveshjes. Marrëveshja dhe protokollit është nënshkruar në datën 8 korrik 2021 dhe ratifikuar në janar 2022, hyrë në fuqi shkurt 2022.

Shqipëria është, po ashtu, palë e memorandumeve mirëkuptimi (MM) dhe e marrëveshjeve për migracionin me vendet e tjera, në fusha si, për shembull, migracionin e paligjshëm, lufta kundër terrorizmit, krimin të organizuar, trafikimit të paligjshëm të narkotikëve, shkëmbimit të informacionit mbi çështjet e migracionit dhe kontrollit, si dhe çështjeve e azilit. Përveç kësaj, Shqipëria është e angazhuar në bashkëpunimin dypalësh me vendet kryesore të destinacionit për shtetasit shqiptarë.

C.2.3 Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Agjenda 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm e ka konfirmuar migracionin si një prioritet të rëndësishëm global. Po ashtu, formulimi i një Marrëveshjeje Globale mbi Migracionin²² në korrik 2018 pritet të sigurojë një kornizë unifikuese të parimeve të përbashkëta, angazhimeve dhe të mirëkuptimeve midis shteteve anëtare për të gjitha aspektet e migracionit ndërkombëtar, duke përfshirë dimensionet humanitare, të zhvillimit dhe të drejtave të njeriut, duke përmirësuar, gjithashtu, bashkëpunimin ndërkombëtar për migracionin. Shqipëria është një nga vendet që e ka vendosur agjendën 2030, si pjesë të prioriteteve të veta kombëtare dhe, po ashtu, ka mirëpritur **Marrëveshjen Globale mbi Migracionin** dhe objektivat e saj. Strategjia Kombëtare e Migracionit 2024–2030 do të përputhet plotësisht me objektivat e Kompaktit Global të Migracionit (GCM), i cili është miratuar nga vendi ynë gjatë Konferencës Ndërqeveritare Marakesh, më datë 10 dhe 11 dhjetor 2018, duke rezultuar si një hap pozitiv në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar për

²⁰ Ligj nr. 22/2018, “Për strehimin social”: <https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2018/12/ligj-nr-22-dt-3.5.2018.pdf>

²¹ Ligj nr. 14/2016, “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë”:

<https://mb.gov.al/ligj-nr-14-2016-per-identifikimin-dhe-regjistrimin-e-adreses-se-shtetasve-shqiptare-qe-jetojne-jashte/>

²² Marrëveshja njihet ndryshe edhe si Pakti Global për Migracionin (*Global Compact on Migration*).



menaxhimin e migracionit. Ministria e Brendshme ka qenë mjaft e angazhuar në ndjekjen e zbatimit të objektivave të Paktit. Që nga vitit 2018 janë hartuar 2 raporte të rishikimit vullnetar të statusit të zbatimit të GCM-së në Shqipëri.

Shqipëria merr pjesë aktive në disa procese konsultative rajonale dhe ndërkombëtare. Ajo është, gjithashtu, pjesë e nismave të ndryshme që promovojnë lëvizshmërinë për punë, menaxhimin më të efektshëm të flukseve migratore në rajon, sigurinë kufitare, tregtinë e lirë dhe zhvillimin, si dhe sigurinë.

Procesi i Budapestit është një dialog ndërrajonal mbi migracionin që shtrihet nga Evropa në rajonin e Rrugëve të Mëndafshit, duke mbuluar edhe fqinjët lindorë të Evropës, Ballkanin Perëndimor dhe Azinë Qendrore. Ai siguron një platformë për dialog dhe bashkëpunim operacional për mbi 50 qeveri dhe disa organizata ndërkombëtare.

Procesi i Budapestit kryesohet nga Turqia dhe bashkëkryesohet nga Hungaria. Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit (ICMPD) është ngarkuar me funksionet e mbështetjes dhe sekretariatit teknik për procesin e Budapestit.

Procesi i Pragës është një dialog ndërkombëtar i dedikuar për çështjet e migracionit, ku marrin pjesë rreth 50 shtete, ndër të cilat edhe Shqipëria. Ky proces promovon partneritetet e migracionit midis vendeve të Bashkimit Evropian, zonës *Shengen*, Partneritetit Lindor, Ballkanit Perëndimor, Azisë Qendrore, Rasisë dhe Turqisë. Gjatë periudhës janar 2021–shtator 2022 vendet anëtare të procesit, përfshirë Shqipërinë, punuan nëpërmjet një sërë takimesh konsultative për draftimin e Planit të Veprimit të Procesit të Pragës, për periudhën 2023–2027. Plani i veprimit dhe deklarata ministeriale u miratuan në Konferencën e 4-rt Ministrore të Procesit të Pragës, organizuar nga Presidenca Çeke e Këshillit të BE-së, në datat 24–25 tetor 2022, pasi ishin dakordësuar më parë në Takimin e Zyrtarëve të Lartë të Procesit të Pragës, zhvilluar në 12–13 maj 2022 në Vjenë.

Rrjeti i Pikave të Kontaktit për Migracionin, të Këshillit të Evropës. Ideja e krijimit të këtij rrjeti, në ministritë përkatëse që merren me çështjet e

migracionit u propozua gjatë shkëmbimit informal të mendimeve për migracionin në Komitetin e Ministrave (të KE) më 13 nëntor 2018.

Qëllimi kryesor i rrjetit është lehtësimi i shkëmbimit të informacionit me interes të ndërsjellë, duke promovuar një kuptim më të mirë të sfidave aktuale dhe atyre në zhvillim me të cilat përballen vendet anëtare, si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira. Në vitin 2022, rrjeti ka arritur të ketë pika kontakti në 46 vende anëtare të Këshillit të Evropës.

Në kuadër të ndjekjes së proceseve rajonale e ndërkombëtare sa më sipër, Shqipëria ka nënshkruar 3 deklarata ministeriale, angazhimet e të cilave forcojnë bashkëpunimin tonë në nivel politik dhe operacional, për të përmbushur angazhimet tona dhe arritjet e qeverisë shqiptare në fushën e migracionit:

- Deklarata Ministrore Pragës, 24–25 tetor 2022
- Deklarata Ministrore e Shkupit, 15–16 nëntor 2022.
- Dekrata në Ministerialin e Tiranës, 3–4 nëntor 2022.

Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI) është ideuar në vitin 2003, në kuadër të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe është lançuar zyrtarisht, më 5 prill 2004. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 22.12.2004, “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për krijimin e forumit rajonal të nismës së migrimit, azilimit dhe kthimit të refugjatëve”, Shqipëria është anëtarësuar në forumin rajonal të qendrës MARRI. Nisma Rajonale për Migrim, Azil, Refugjatë (MARRI); objektivat/fushat e veprimit të kësaj nisme dhe Qendrës së saj përqendrohen në kontributin për lëvizjen e rregullt dhe të lirë të njerëzve, në interes të sigurisë dhe prosperitetit, që lidhen me fushat e mëposhtme, si: migrimi, azili, ripranimi, menaxhimi i integruar i kufijve, politika e vizave dhe bashkëpunimi konsullor dhe kthimi i refugjatëve/të të zhvendosurve etj.

Po ashtu, projekte dhe programe në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare, si: projekti “ARISE ALL” dhe programi “Migracioni & Diaspora”. Këtu përfshihen nisma rajonale, siç janë: Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët²³; Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal²⁴;

²³ Shqipëria ka mbajtur kryesinë e kësaj nisme nga prillit 2010 deri në prill 2011.

²⁴ Shqipëria është anëtare e bordit.



Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore²⁵; Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore; Nisma e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore; Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore;²⁶ Nisma e Evropës Qendrore; dhe Nisma Adriatiko-Joniane²⁷.

C.3 Kuadri institucional

C.3.1 Institucionet qeveritare

Në nivelin ndërinstitucional, nga viti 2019 deri në vitin 2022, përgjegjësia e institucioneve në menaxhimin e çështjeve migratore ka mbetur e njëjtë si ajo e pasqyruar në Profilin Vjetor të Migracionit të vitit 2018. Me miratimin e ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, janë detajuar përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për trajtimin të huajve. Konkretisht:

- Ministria e Brendshme

Strukturat përgjegjëse për trajtimin e të huajve në varësi të Ministrisë së Brendshme, si: Drejtoria e Politikave për Antitrafikut dhe Migracionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nëpërmjet Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, Drejtorisë së Përgjithshme kundër Krimit të Organizuar dhe kundër Krimeve të Rënda, Drejtoria e Politikave për Azilin, Shtetësinë dhe të Huajt, janë përgjegjëse kryesore, për: kontrollin e të huajve lidhur me procedurat e aplikimit për vizë për hyrjen në Republikën e Shqipërisë në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera të MEPJ-së dhe SHISH-it; parandalimin dhe luftën kundër migracionit të parregullt nëpërmjet menaxhimit të integruar të kufijve; kontrollin kufitar mbi kushtet dhe kriteret për hyrjen, qëndrimin dhe kalimin tranzit në Republikën e Shqipërisë; pajisjen e të huajve me leje qëndrimi; kontrollin e ligjshmërisë së qëndrimit të të huajve në territor dhe marrjen e masave të largimit vullnetar, dëbimin, ndalimin e të huajve të parregullt në territor dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës, apo në vendin tranzit nga kanë ardhur; zbatimin e Marrëveshjeve të Ripranimit me vendet e tjera; pritjen, intervistimin dhe përzgjedhjen e shtetasve të kthyer në kufi, si dhe informimin e tyre mbi mundësitë e riintegrimin në vend; bashkëpunimin rajonal dhe me gjerë në fushën e shkëmbimit të të dhënave statistikore mbi migracionin e paligjshëm dhe paralajmërimin e

hershëm; identifikimin dhe trajtimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të personave në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe Procedurave Standarde të Veprimit për identifikimin, referimin dhe asistimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit; përsi dhe të miturit e pashoqëruar, për luftën kundër trafikimit dhe kontrabandimit të personave, për azilin dhe shtetësinë etj. Si autoriteti përgjegjës për trajtimin e të huajve që hyjnë, kalojnë tranzit apo qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, struktura përgjegjëse për kufirin dhe migracionin në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është e organizuar në nivel qendror dhe vendor e shtrihet në të gjithë territorin e RSH-së.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), nëpërmjet drejtorive në përbërje të saj dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e zhvillimit të politikave shtetërore për emigracionin dhe imigracionin e punës dhe çështjet e lidhura me këto politika: punësimi, arsimi dhe formimi profesional, marrëveshjet dypalëshe ndërkombëtare për mbrojtjen sociale, marrëdhëniet e punës etj. Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka detyrimin të ofrojë shërbime për shtetasit shqiptarë, që duan të emigrojnë dhe ata që kthehen nga emigracioni. Një tjetër kategori shtetasish që merr shërbime pranë kësaj agjencie janë dhe shtetasit e huaj që dëshirojnë të punojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Me miratimin e ligjit 79/2021, “Për të huajt”, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk lëshon më dokumente pune (leje pune, ose certifikatë regjistrimi në punë) por jep *online* miratimin për punësim në funksion të lëshimit të lejes unike. Kjo e fundit lëshohet nga autoritetet e MB-së (DKM).

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) është institucion buxhetor publik, në varësi të ministrit përgjegjës për punësimin dhe zhvillimin e aftësive dhe ka për mision të sigurojë përmbushjen e së drejtës së shtetasve shqiptarë, të huaj dhe pa

²⁵ Shqipëria ka mbajtur kryesinë nga qershori 2014 deri në qershor 2015.

²⁶ Shqipëria e ka kryesuar gjatë vitit 2012.

²⁷ Shqipëria ka mbajtur kryesinë nga qershori 2013 deri në maj 2014.



shtetësi, që kanë marrë statusin e refugjatit dhe të azilkërkuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, për t'u trajtuar me shërbime publike dhe programe punësimi, vetëpunësimi dhe kualifikime profesionale, për të gjetur një punë të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit. AKPA e ushtron veprimtarinë e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore, në nivel rajonal, nëpërmjet 12 drejtorive rajonale dhe në nivel vendor nëpërmjet zyrave vendore.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSSH) është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e legjislacionit të punës. Ai garanton zbatimin e dispozitave ligjore, në lidhje me kushtet e punës dhe mbrojtjen e punonjësve. ISHPSSH-ja është organizuar në dy nivele: qendror dhe rajonal.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

MEPJ-ja është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së vizave, si dhe negocimin e akteve të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migracionit; mbështetjen e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, nxitjen dhe ndihmën për zhvillimin e komunikimit e të ndërveprimit të diasporës, bashkërendimin e veprimeve me strukturat e Ministrisë së Brendshme për ripranimin e shtetasve shqiptarë etj. Nëpërmjet strukturave në varësi të saj, të tilla si struktura për çështjet konsullore, është përgjegjëse për trajtimin e të huajve, hartimin e politikave të hyrjes e qëndrimit të tyre në RSH, trajtimin e kërkesave për vizë, si dhe nëpërmjet përfaqësive diplomatike, zyrave konsullore jashtë vendit, zyrave konsullore të nderit të Republikës së Shqipërisë, agentëve të tjerë të kontraktuar në shtete të huaja, në bashkëpunim edhe me autoritetin përgjegjës vendor për çështjet e kufirit dhe migracionit në pikat e kalimit kufitar për rastet e përcaktuara në ligji është përgjegjës për pranimin e kërkesave për vizë dhe lëshimin e vizave janë

Gjithashtu, nëpërmjet Drejtorisë së Diplomacisë Ekonomike, Publike dhe Diasporës realizon ndërveprimin, koordinimin dhe bashkëpunimin me përfaqësitë, institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë: i. ndjek me ndihmën e përfaqësive diplomatike në botë përditësimin e materialeve mbi historikun e diasporës shqiptare, vendosjen e saj, statusin juridik, gjendjen ekonomike dhe arsimore,

jetën kulturore dhe organizimin në shoqata e klube, rolin e saj në jetën politike dhe shoqërore të vendit pritës, personalitetet më të shquara, mediet në gjuhën shqipe etj.; ii. grumbullon, përpunon dhe përditëson informacionin, me qëllim hartimin e studimeve të përditësuara në vazhdimësi për diasporën në vende të veçanta, për shoqatat dhe organizatat e diasporës; iii. bashkëpunon me organizma ndërkombëtarë, si: IOM-i, ILO-ja etj. dhe me sektorët paralelë të të njëjtut nivel të institucioneve shtetërore, si: Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, që, në një mënyrë a një tjetër, lidhen me diasporën, si dhe me mediet elektronike dhe shtypin e shkruar në gjuhën shqipe në diasporë dhe në vend; iv. ndjek problemet dhe veprimtaritë e ndryshme kulturore e artistike të diasporës dhe për diasporën në Shqipëri dhe në vendet ku ajo jeton e punon, në funksion të detyrës për krijimin e një imazhi real për shqiptarët dhe Shqipërinë.

- Ministri i Shtetit për Diasporën

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Diasporën”, nisi funksionimi i institucionit të ministrit të Shtetit për Diasporën. Misioni i ministrit ishte të përfaqësonte e të nxiste politikat e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur e fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë. Me miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 9.2.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, të ndryshuar, fushat e përgjegjësisë së ministrit të Shtetit për Diasporën, kaluan në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Strukturat e ngritura për të mundësuar realizimin e misionit të ministrit të Shtetit për Diasporën vijuan funksionimin edhe pas kalimit në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në vitin 2022. Konkretisht:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës

Agjencia Kombëtare e Diasporës e krijuar me ligjin nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, ka për mision zhvillimin dhe konsolidimin e bashkë-



punimit institucional me diasporën, nëpërmjet: a) përmirësimit të pozitës së diasporës dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të saj, aty ku gjendet; b) ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe të trashëgimisë kulturore kombëtare; c) nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe të diasporës; d) bashkëpunimit për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Fondi ka për mision sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare në kuadrin e nxitjes së zhvillimit social-ekonomik e kulturor, bazuar në strategjinë kombëtare për diasporën, përmes promovimit dhe nxitjes së prirjeve filantropike dhe investimeve në mbështetje të zhvillimit të diasporës në Republikën e Shqipërisë e jashtë saj.

- Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD)

QBD-ja është përgjegjëse për: a) botimin, në përputhje me ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të teksteve që do t'i shërbejnë diasporës; b) redaktimin përfundimtar të teksteve që do të botohen; c) nxitjen e qasjes në internet për tekste të veçanta për diasporën; ç) nxitjen e krijimit të formateve të posaçme për librat elektronikë; d) bashkërendimin e punës me operatorin ekonomik që bën shpërndarjen e teksteve; dh) koordinimin me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për botimet për diasporën.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të integritimit social të të huajve, duke kontribuar në sigurimin e aksesit në kujdes shëndetësor, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, si dhe përkujdesjen sociale e shanse të barabarta, në zbatim legjislativ në fuqi. Ajo mbështet integrimin e emigrantëve të kthyer dhe migrantëve të brendshëm në sistemin shëndetësor, të sigurimeve shëndetësore dhe mbrojtjes sociale. Struktura e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që realizon detyrimet dhe përgjegjësitë e këtij institucioni në fushën e migracionit është Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Ministria e Arsimit dhe Sportit

MAS-i kontribuon në integrimin e shtetasve të huaj në Shqipëri në fushën e arsimit dhe shkencës, si dhe është përgjegjëse për procesin e botimeve shkollore e kërkimore-shkencore, si dhe të teksteve të veçanta, të cilat i shërbejnë diasporës.

C.3.2 Institucione të tjera publike

- Instituti i Statistikave

INSTAT-i është përgjegjës për grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe shpërndarjen dhe publikimin e statistikave në fushën e migracionit. Ky institut kryen anketime dhe prodhon raporte mbi situatën e migracionit në vend. Për hartimin e këtij dokumenti është vlerësuar informacioni i mbledhur Censit të Popullsisë dhe Banesave 2011, të dhënat nga anketat tremujore të Forcave të Punës (AFP), për periudhën 2019–2022. Në pyetësinë e AFP-së është shtuar një modul i posaçëm për migracionin, i hartuar në përputhje me përkufizimet specifike të KB-së dhe Eurostatit. Referuar migracionit të brendshëm, të dhënat merren elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar nga INSTAT-i me këtë institucion. Në këtë mënyrë mundësohen të dhëna më cilësore dhe të plota mbi statistikën e popullsisë dhe lëvizjet e brendshme.

- Avokati i Popullit

Mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”, Avokati i Popullit, si mbrojtës dhe promovues i të drejtave të njeriut, zhvillon një sërë monitorimesh për masat dhe politikën që janë ndërmarrë për çështjet e emigracionit, kthimin e shtetasve shqiptarë nga vendet e Evropës dhe riintegrimin e tyre, si dhe masat e ndërmarra dhe procedurat e azilit për azilkërkuesit e mundshëm që vijnë nga zonat e luftës, mbi respektimin e të drejtave të migrantëve, refugjatëve dhe azilkërkuesve, rëndësinë e sigurimit të kushteve të përshtatshme të pritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në kufijtë e saj, si dhe detyrimet qeverisë së Republikës së Shqipërisë për administrimin e flukseve të përziera migratore, duke respektuar standardet e të drejtave të njeriut,

- Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë kryen dhe boton studime të ndryshme për remitancat dhe rëndësinë e tyre në ekonominë shqiptare, duke dhënë një sërë rekomandimesh për të eliminuar barrierat që lejojnë



shfrytëzimin më të mirë të potencialit të tyre social dhe ekonomik.

C.3.3 Aktorë të tjerë në fushën e migracionit

Një sërë organizatash të Kombeve të Bashkuara mbështesin çuarjen përpara të hartimit dhe të zbatimit të politikave kombëtare, mes të cilave spikatin:

Organizata të Kombeve të Bashkuara dhe partnerë ndërkombëtarë.

- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) vazhdon të mbetet partneri kryesor strategjik i qeverisë shqiptare në mirëqeverisjen e migracionit, duke kontribuar në hartimin dhe zbatimin e politikave migratore në të mirë të migrantëve dhe gjithë shoqërisë shqiptare, në përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit dhe forcimit të institucioneve. IOM-i mbështet përfshirjen aktive të shoqërisë civile dhe sektorit privat në të gjitha nismat që trajtojnë çështje migratore. Për më tepër, IOM-ja mbështet qeverinë shqiptare, në kuadër të dialogut rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e migracionit.

Hartimi dhe publikimi i këtij Profili të Zgjeruar të Migracionit është mbështetur nga Misioni i IOM-së në Shqipëri.

- Komisioneri i Lartë i OKB për Refugjatët (UNHCR) angazhohet në çështjet e migracionit që prekin refugjatët dhe kategoritë e tjera në mandatin e tij, që përfshijnë azilkërkuesit, të zhvendosurit brenda territorit dhe personat pa shtetësi. Organizata ka luajtur një rol thelbësor në çuarjen përpara të legjislacionit për azilin në vend dhe për trajtimin e sfidave institucionale lidhur me azilkërkimin dhe garantimin e mbrojtjes ndërkombëtare për personat në nevojë.

- Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) është një organizatë lider në fushën e migracionit të punës dhe të sigurimit të mbrojtjes së punëtorëve emigrantë. Në kontekstin shqiptar organizata luan një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave të punësimit, përfshi dhe ato të punësimit jashtë vendit apo për migrantët e kthyer.

- Organizata të tjera të OKB-së që trajtojnë çështje të lidhura ngushtësisht me migracionin janë Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), i cili ndihmon qeverinë shqiptare në trajtimin e nevojave të tregut të punës në Shqipëri (ritjen e aftësive të punëkërkuesve të papunë, përfshi grupet e marginalizuara të popullsisë, mbështetjen e sipërmarrësve të rinj etj.).

- Organizata e OKB-së për fëmijët, e njohur ndryshe edhe si UNICEF-i (Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara i Emergjencës për Fëmijët), ndihmon në forcimin e kapaciteteve vendëse për t'u përballur me sfidat që lidhen me migrimin e të miturve, shfrytëzimin dhe trafikimin e tyre dhe për të siguruar një mbrojtje të mjaftueshme dhe afatgjatë.

- Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) mbështet një sërë programesh që synojnë adresimin e sfidave migratore. Kështu, GIZ-ja është pala kontraktuese me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për marrëveshjen e zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri” (ligji ratifikues nr. 59/2018). Objektivi i projektit “Këshillimi për migracionin” është lufta kundër migracionit të parregullt, duke ofruar informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës dhe duke informuar për arsimin dhe formimin profesional, si dhe perspektivat e tregut të punës në Gjermani dhe në Shqipëri.

- Organizata të shoqërisë civile

Në Shqipëri ka një sërë organizatash që zhvillojnë aktivitetin e tyre jofitimprurës në dobi të kategorive të ndryshme të migrantëve. Lista e mëposhtme nuk është shteruese, por paraqet disa prej tyre që janë, veçanërisht, aktive në riintegrimin e migrantëve të kthyer, përfshi edhe riintegrimin e kategorive në nevojë të migrantëve.

Terre des hommes është një organizatë në mbrojtje të fëmijëve zbaton një sërë programesh që synojnë ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm për mbrojtjen e fëmijëve ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit. Organizata është, gjithashtu, aktive në identifikimin dhe në zbatimin e praktikave më të mira për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga migracioni.

World Vision është një organizatë zhvillimi komunitar, e cila punon në 220 komunitete në nevojë dhe ndihmon rreth 30 mijë fëmijë në 13 bashki të vendit, për të siguruar drejtësi sociale, mundësi zhvillimi ekonomik për fëmijët dhe të rinjtë më në nevojë. Organizata asiston riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga migracioni përmes mbështetjes me biznese të vogla për të kthyerit apo



ndërhyrjeve sociale në komunitetet ku të kthyerit vendosen.

“*Të ndryshëm dhe të barabartë*” është një organizatë lokale misioni i së cilës është riintegrimi i suksesshëm në shoqëri i viktimave të trafikimit, të shfrytëzimit dhe dhunës. Për të mundësuar një riintegrim të qëndrueshëm dhe afatgjatë, organizata ka krijuar modele shumë të suksesshme të biznesit social, të cilat angazhojnë aktivisht viktimat (e mundshme) të trafikimit. Kjo organizatë është pjesë e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik, ku bëjnë pjesë edhe organizata të tjera si qendra psikosociale “Vatra”, shoqata “Tjetër vizion”, si dhe Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit në Tiranë.

Caritas Albania është një organizatë e cila ka bashkëpunuar për arritjen e objektivave të përbashkët në përmirësimin e shërbimeve për mbështetjen e grupeve miks migratore që hyjnë në Shqipëri.

Qendra për Studime Sociale Ekonomike përfaqëson një organizatë lokale aktive në fushën e kërkimit shkencor për migracionin. Ajo numëron dhjetëra artikuj dhe vrojtime mbi aspekte të ndryshme të migracionit shqiptar.

D. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

D.1 Përfundime

Nga studimi i zhvillimeve të migracionit shqiptar në periudhën 2019–2022 mund të nxirren disa përfundime të përgjithshme:

1. Gjatë periudhës 2019–2022, migracioni neto, i cili shënoi një rënie nga -8,1 persona për mijë banorë më 2019-n në -11,7 persona për mijë banorë më 2022-shin.

2. Dukuria e azilkërkimit nga shtetasit shqiptarë në vendet e BE-së ka pësuar rënie nga 17 065 në vitin 2019 në 10 645 në vitin 2022. Por, ka rritje të azilkërkimit të shtetasve shqiptarë në Mbretërinë e Bashkuar nga 3 453 në vitin 2019 në 14 223 në vitin 2022.

3. Emigrimi i të miturve kryesisht drejt vendeve të BE-së pavarësisht një trendi rënës përgjatë 2020-s dhe 2021-shit, ndikuar dhe nga kriza e COVID-19, më 2022-shin numri i të miturve që kanë kërkuar azil është rritur dhe ka kaluar numrin në 2019 me 6.2%.

4. Në periudhën 2019–2022 janë shtuar kanalet e rregullta të emigrimit ndërkombëtar të shtetasve shqiptarë, kryesisht të BE-së.

5. Pandemia e COVID-19 uli përkohësisht emigracionin dhe zvogëloi përqindjet e pjesëmarrjes

në tregun kombëtar të punës, duke çuar në një rritje të shkallës së papunësisë për një periudhë afatshkurtër.

6. Kthimi i punëtorëve migrantë nga vendet kryesore të destinacionit nxori në pah sfidën e përdorimit sa më të mirë të aftësive të tyre dhe integrimin e tyre në tregun shqiptar të punës.

7. Numri i shqiptarëve të cilëve iu është refuzuar hyrja në një shtet të BE-së në kufi ka rënë ndjeshëm nga viti 2019 në 2021, me një diferencë prej 13.4%. Po ashtu, numri i shqiptarëve të urdhëruar për t'u larguar nga territori i një vendi të BE-së ka pësuar një rënie prej 25.7%, gjatë katër vjetëve të fundit

8. Numri i të kthyerve gjatë viteve 2019–2022 të evidentuar nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, ka pësuar rënie rënë me 47.3%.

9. Prej viti 2019 vërehet rënie e numrit të të kthyerve që kërkojnë shërbime në sportelet e migracionit. Nga 550 persona më 2019-n, në vitin 2022 vetëm 32 persona kanë kërkuar shërbime në sportelet e migracionit.

10. Gjatë periudhës 2019–2022 numri shtetasve të huaj në përpjekje për të kaluar tranzit nëpërmjet territorit shqiptar me synim vendet e BE-së pati një rritje të lehtë prej 2,7%. Në vitet 2020 dhe 2021 shënohen vlerat më të larta.

11. Gjatë periudhës 2019–2022 ka një rritje në vlerë absolute të migracionit neto, nga -23082 në vitin 2019, në -32497 në vitin 2022

12. Gjatë periudhës 2019–2022 Shqipëria ka shërbyer edhe si vend pritës kryesisht për imigrantë ekonomikë, studentë, refugjatë dhe azilkërkues. Sipas motivit të qëndrimit, numrin më të madh të të huajve e përbëjnë ata që qëndrojnë në Shqipëri për arsye punësimi dhe humanitare, përqendruar kryesisht në qarkun e Tiranës.

13. Shqipëria vazhdon të ketë varësi nga dërgesat e emigrantëve, të cilat janë rritur nga 702 milionë euro në vitin 2019 në 833.7 milionë euro në vitin 2022.

14. Emigrimi ndërkombëtar vazhdon të ndikojë në rritjen e moshës mesatare së Shqipërisë, nga 36,7 më 2019-n në 38,2 në vitin 2022. Kjo si pasojë krahas së lindshmërisë dhe flukseve migratore që vazhdojnë të përfshijnë një popullsi relativisht të re.

15. Popullsia në moshë pune ka pësuar rënie me 3,49%, ndërkohë që edhe niveli i papunësisë është ulur nga 11,25 më 2019-n në 10,9 në vitin 2022. Ritmet e rritjes së punësimit nuk kanë mundur të ndjekin ritmet e rritjes së popullsisë, dukuri që përbën një sfidë për tregun e punës.



16. Tregu i punës në Shqipëri ka pasur ofertë në rritje gjë e cila reflektohet dhe tek ulja e nivelit të papunësisë te grup-mosha 20-40 vjeç, nga 15,4% në 14,6%.

17. Përgjatë viteve 2019–2022 vihet re një trend rënës i popullsisë nën 15 vjeç dhe i forcës së punës (15–64 vjeç) dhe një rritje e popullsisë mbi 65 vjeç. Përkatësisht, për vitin 2019, popullsia nën 15 vjeç përbënte 17.2% të popullsisë, për 2020 16.8%, për 2021 16.5% dhe për 2022 16.3%.

18. Gjatë 2019–2022, vetëm Tirana ka një migrim të brendshëm pozitiv. Të gjitha prefekturat e tjera kanë pasur migracion të brendshëm neto negativ gjatë viteve 2019–2022 dhe, në veçanti, qarqet e Dibrës, të Gjirokastrës dhe të Kukësit.

D.2 Rekomandime

Në kushtet aktuale, kur: i. migracioni mbetet një nga çështjet kryesore me interes publik në Shqipëri dhe Evropë dhe me ndikim të dukshëm në negociatat e Shqipërisë me BE-në për anëtarësim; ii. Shqipëria vazhdon të prodhojë flukse emigrantësh ekonomikë, ndërkohë që popullata vjen në rënie dhe kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë shqiptare; iii. Shqipëria është një vend tranziti për imigrantët, refugjatët dhe azilkërkuesit, është e nevojshme që të intensifikohen përpjekjet për mirëqeverisjen e migracionit në vend.

D.2.1 Rekomandime për qeverisjen e migracionit

Intensifikimi i përpjekjeve për një qasje të koordinuar strategjike ndaj çështjeve të migracionit, duke ndjekur parimin “e gjithë qeveria”, është një element kyç për detyrën e përgjithshme të Shqipërisë për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive sfidave të reja në fushën e qeverisjes së migracionit nëpërmjet.

- Përmirësimi të kuadrit ligjor dhe institucional, i cili siguron përafrimin e normave dhe standardeve kombëtare me ato të BE-së dhe angazhimeve të tjera ndërkombëtare.

- Hartimit dhe rishikimit të politikave të migracionit bazuar në të dhëna të sakta dhe të koordinuara duke vendosur në vëmendje të të gjitha institucioneve të mbledhin, analizojnë dhe ndajnë të dhënat e migracionit si themeli për krijimin e politikave të bazuara në evidenca.

- Forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneriteteve globale për migrimin e sigurt dhe të

rregullt, duke theksuar rëndësinë e nxitjes së bashkëpunimit ndërkombëtar të forcuar dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në partneritetet globale për të garantuar që migrimi të jetë i sigurt, i rregullt dhe i rregullt.

- Parandalimit të fenomenit të migrimit të parregullt drejt dhe nga Shqipëria, duke ndërmarrë ca veprimet parandaluese në të gjitha fazat e procesit migrator, duke lidhur në rastin e emigrimit të shtetasve shqiptarë, stimujt për hyrjen në tregun kombëtar të punës, dhënien e informacionit mbi rreziqet që lidhen me migrimin e parregullt dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve vulnerabël.

- Përfshirja e njësive të vetëqeverisjes vendore në strukturat koordinuese dhe monitoruese për çështje migratore.

D.2.2 Rekomandime për zhvillimin e politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik kombëtar/lokal

- Garantimi i kushteve institucionale dhe ligjore për migrimin për motive punësimi drejt dhe nga Shqipëria, kombinuar reformat legjislativë (përmirësimi i kuadrit ligjor), përmirësimin e aksesit të migrantëve në informacionin, duke ndërmarrë reforma legjislativë mbi migrimin e rregullt për qëllime punësimi.

- Sigurimi i një mjedisi etik të sigurt dhe jodiskriminues rekrutimi përmes rregullimit të agjencive private të punësimit.

- Krijimi i kushteve, skemave konkrete kombëtare se si emigrantët mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, gjë që do të kërkojë ndërlidhje me investimet lokale, gjithashtu planifikimin dhe lehtësimin e transferimit të remitançave dhe përfshirjen financiare të migrantëve.

- Sigurimi i riintegrit të qëndrueshëm të qytetarëve shqiptarë të kthyer nga emigracioni duke synuar shfrytëzimin e potencialit profesional të të kthyerve shqiptarë nga emigracioni.

D.2.3 Rekomandime për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare

- Përmirësimin e infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar dhe ambientet e pritjes, si dhe ofrimin e shërbimeve zyrtare të përkthimit për të përmbushur më mirë nevojat e migrantëve në



situata vulnerabël, fëmijëve, të rinjve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

- Sigurimi i programeve afatgjata për integrimin e të huajve, duke shtrirë garancitë e mbrojtjes së të drejtave dhe trajtimin jodiskriminues për të gjithë personat e huaj që banojnë në Shqipëri.

- Përfshirja e njësive të vetëqeverisjes lokale në lehtësimin e përfshirjes së migrantëve në vendim-marrjen e komuniteteve lokale.